

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5910  
E martë, 22 tetor 2019  
çmimi 0.40 €

## Vitin e ardhshëm Japonia hap ambasadën në Prishtinë

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", BAJRUSH XHEMAJLI

FAQE 4-5

## Qeveria e re nuk do ta ketë të lehtë përballjen me PDK-në

Nënkryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bajrush Xhemajli, ka thënë se zgjedhjet e 6 tetorit janë më të mirat që janë mbajtur deri më tani në Kosovë. Ai ka vlerësuar se rinumërimi i qindra vendvotimeve nuk e cenon procesin zgjedhor. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Xhemajli ka paralajmëruar se PDK-ja do të bëjë opozitë të fuqishme. Sipas tij, qeveria e re nuk do ta ketë të lehtë përballjen me PDK-në. Xhemajli ka thënë se propaganda e opozitës, koalicioni PAN dhe qëndrimi i gjatë në qeverisje kanë qenë faktorët që kanë penalizuar PDK-në në zgjedhjet e 6 tetorit. Megjithatë, ai ka theksuar se nuk janë ndarë keq me vota, pasi që kanë më shumë se në dy palë zgjedhjet e fundit



### OPINION

**SHENGENI SERBO-CENTRIK  
OSE BALLKANI MIDIS  
EUROATLANTIZMIT DHE  
EURO-AZISË**

F. 11

Prof. Lisen  
BASHKURTI



### AKTUALE

**AZEM SYLA FTOHET PËR  
INTERVISTIM NGA GJYKATA  
SPECIALE**

F. 5

**ZARFET NGA SERBIA, LIROHEN  
NGA SPITALI 12 PACIENTËT**

F. 7

**FOTOGRAFIA BRENDA  
SHKOLLËS ME FLAMURIN  
TURK DHE ME PËRSHËNDËTJE  
USHTARAKE SJELL REAGIME  
TË SHUMTA**

F. 7

### EKONOMI

**KOSOVA NËNSHKRUAN  
MARRËVESHJEN PËR  
ELIMINIMIN E TATIMIT TË  
DYFISHTË ME ARABINË SAUDITE**

F. 9

**TRE ISH-DREJTUESIT E  
TELEKOMIT LIROHEN NGA  
AKUZAT LIDHUR ME KONTRATËN  
ME 'Z-MOBILE'**

F. 9

### SPORT

**RIJAD  
BYTYQI, E  
ARDHMJA E  
PORTËS SË  
KOSOVËS**

F. 18



## Rinumërimi rrit gjasat e koalicionit Nisma-AKR-PD për kalim të pragut

FAQE 3

Rinumërimi i 530 vendvotimeve ka sjellë shpresë të madhe te koalicioni Nisma-AKR-PD për kalimin e pragut zgjedhor prej pesë përqindësh. Zyrtarët e këtij koalicioni janë shprehur të bindur se me evitimin e parregullsive që po i shpërfaq procesi i rinumërimit të votave ky koalicion do të jetë pjesë e legjislaturës së shtatë të Kuvendit të Kosovës. Madje zyrtarët e të tri partive politike të koalicionit pretendojnë se nëse kalohet pragu prej pesë përlindësh secila prej këtyre partive do t'i ketë deputetët e vet në Kuvend



**Ambasadat  
gjermane  
përgatiten  
për fluksin  
e vizave**

FAQE 9

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Kurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



## Makroni do t'i vizitojë Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut

PARIS, 21 TETOR - Presidenti francez Emmanuel Macron pritet t'i vizitojë Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut muajin e ardhshëm. Në komentin e tij publik pas bllokimit të hapjes së negociatave me këto vende, ai u shpreh se do të takohet me kryeministrat Rama dhe Zaev për të folur për reformat dhe hapat që duhet të bëjnë këto vende. Me vizitën e tij Makroni duket se ka për qëllim t'u dëshmojë Shqipërisë dhe Maqedonisë se perspektiva evropiane e këtyre vendeve është e hapur dhe Franca do t'i ndihmojë për të arritur këtë

objektiv. Një burim diplomatik në Tiranë u shpreh për Exit.al se ende nuk ka detaje për këtë vizitë, pasi ajo është vendosur së fundmi dhe mbetet ende një premtim në parim.

Burimi diplomatik konfirmoi se si shenjë të mbështetjes së Francës për Shqipërinë, presidenti Makron ka vendosur hapjen në Tiranë të zyrës të Agjencisë Franceze të Zhvillimit, e cila do të zbatojë ndihmën e Francës për projekte zhvillimi në Shqipëri. Me gjasa, ky hap mund të shënojë rritje të ndihmës franceze, e cila deri tani nuk ka

qenë donator i rëndësishëm i Shqipërisë. Makroni kishte planifikuar ta vizitonte Shqipërinë fillimisht në vjeshtën e vitit 2018, në një turne ballkanik, por ky turne u anulua. Makroni vizitoi Serbinë më 16 korrik, pas anulimit të Samitit të Parisit në lidhje me negociatat Serbi-Kosovë. Edhe këtë herë ai zgjodhi të shmangte Shqipërinë. Duket se reagimi kritik i shumë vendeve evropiane për veton praktike franceze ndaj Shqipërisë dhe veçanërisht ndaj Maqedonisë së Veriut e ka nxitur Makronin që më në fund t'i vizitojë të dy vendet.




## Opozita kërkon dorëheqjen e qeverisë Rama pas moshapjes së bisedimeve

Lideri i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ka kërkuar dorëheqjen e kryeministrit Edi Rama, si përgjegjës për dështimet në procesin e integrimit evropian dhe moshapjen e negociatave me Bashkimin Evropian

TIRANË, 21 TETOR - "Një njeri po na mban peng të gjithëve. Kjo duhet të marrë fund". Kështu u shpreh të hënën kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, duke kërkuar dorëheqjen e kryeministrit Edi Rama si përgjegjës për dështimet në procesin e integrimit evropian dhe moshapjen e negociatave me Bashkimin Evropian. Drejtuesi i bashkimit opozitar theksoi se "situata e rëndë ekonomike, mungesa e mundësive, që vjen prej kapjes së institucioneve dhe pabarazisë para ligjit, ka detyruar shqiptarët të largohen në numra rekord si azilkërkues". "Evropa refuzoi Edi Ramën, jo Shqipërinë. Dështimi është i Edi Ramës, jo i Shqipërisë. Ky mesazh ka qenë më i fortë se kurrë nga Gjermania, që i tha "Po"

Shqipërisë dhe "Jo" qeverisë përmes 9 kushteve që duhen përmbushur. Pa reforma serioze, të cilat ai nuk është në gjendje dhe nuk ka vullnetin t'i bëjë, Evropa do të vazhdojë ta refuzojë Edi Ramën, por ne, shqiptarët, do të vazhdojmë t'i vuajmë pasojat", tha Basha, ka njoftuar voa.

Ai deklaroi se kryeministri Rama duhet t'i kthejë mandatin popullit shqiptar, sepse "shumica e vendeve ishin të një mendje se qeveria e Shqipërisë nuk e meritonte hapjen e negociatave dhe se kushtet treguan që qeveria ka bërë hapa pas". Ai tha se krimi, korrupsioni, blerja e votës, mosfunksionimi i gjykatave, nuk janë probleme të brendshme të Evropës, por të qeverisë Rama. "Kushtet e BE-së janë udhërrëfyesi ynë për të dalë nga kriza,



për të ndërtuar një Shqipëri demokratike, me mundësi për të gjithë qytetarët e saj. Vënia para drejtësisë e te inkriminuarve dhe korruptuarve në nivele të larta janë kërkesat e panegociueshme për hapjen e bisedimeve të anëtarësimit", tha ai.

Basha tha se qeveria e Tiranës duhet të ndjekë shembullin e Maqedonisë së Veriut dhe të largohet nga drejtimi i vendit. "Me një qeveri të re, legjitime, e



dalë nga zgjedhje të lira e të ndershme, që drejton procesin e negociatave evropiane, mirëqenia dhe përparimi është i mundur", tha ai. Por kryeministri Edi Rama hodhi poshtë kërkesat për dorëheqje dhe akuzoi opozitën se ajo punoi shumë fort për ta dështuar procesin. "Ata nuk kanë lënë gur pa lëvizur por nuk ia dolën. Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria nuk morën atë që ju

takonte si rezultat i një përplasje të brendshme në tryezën e familjes evropiane për të ardhmen e Bashkimit Evropian", tha ai.

Rama tha pas një mbledhje të Partisë Socialiste për të njëjtën temë se e vetmja gjë që Shqipëria ka në dorë është të bëjë detyrat e shtëpisë, dhe se përgjigja e fundit nga BE-ja nuk ndryshonte asgjë në trajektoren strategjike të vendit, PS-së dhe qeverisë. "Detyrat tona të shtëpisë janë shumë të qarta. Rruga jonë vazhdon pa asnjë lëkundje dhe pa asnjë ekuivok. Ne duam të bëjmë Shqipërinë evropiane për shqiptarët dhe fëmijët tanë dhe këtë do ta bëjmë përditë", tha ai.

Franca i kujtoi Shqipërisë se ka një numër të lartë azilantësh dhe emigrantësh, gjë që nuk përputhet me kërkesat e saj për integrim evropian, ndërsa Gjermania i kërkoi të ringrejë Gjykatën Kushtetuese dhe t'i dënojë zyrtarët e inkriminuar në korrupsion gjyqësor dhe në krime zgjedhore.

## Stoltenbergu: Procesi i anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut, në rrugë të duhur

BRUKSEL, 21 TETOR - Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë ta ketë garantuar kryeministrin e Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev se procesi i anëtarësimit të këtij shteti në Aleancën veri-atlantike "është në rrugën e duhur". Ai i ka bërë këto deklaratat vetëm disa ditë pasi Bashkimi Evropian ka dështuar t'i ofrojë një datë këtij shteti për nisje të negociatave për anëtarësim.

Stoltenbergu ka thënë se ai ka telefonuar Zaevin për "t'i garantuar përkushtimin për anëtarësimin e

Maqedonisë së Veriut", duke shtuar se "procesi i ratifikimit është në rrugë të mbarë dhe unë mezi pres që Maqedonia e Veriut t'i bashkohet aleancës".

Maqedonia e Veriut ka siguruar një protokoll për anëtarësim në NATO në shkurt të këtij viti, pas arritjes së marrëveshjes me Greqinë një vit më parë për ndryshim të emrit, duke i dhënë fund kontestit për këtë çështje me Athinën.

Deri më tani 24 nga 29 vendet anëtare të NATO-s kanë ratifikuar protokollin për anëtarësim të këtij

shteti.

Zaevi është përballur me 18 tetor me një pengesë të madhe, pasi një grup i vendeve anëtare të BE-së, i kanë bllokuar Maqedonisë së Veriut nisjen e bisedimeve për anëtarësim ashtu sikurse Shqipërisë. Kjo ka detyruar kryeministrin maqedonas të thërrasë zgjedhje të parakohshme, duke thënë se kërkon nga qytetarët të vendosin për rrugën që dëshirojnë të ndjekë shteti i tyre. Prandaj Zaevi ka thënë se zgjedhjet e parakohshme në Maqedoninë e Veriut do të mbahen më 12 prill.





# Rinumërimi rrit gjasat e koalicionit Nisma-AKR-PD për kalim të pragut

Rinumërimi i 530 vendvotimeve ka sjellë shpresë të madhe te koalicioni Nisma-AKR-PD për kalimin e pragut zgjedhor prej 5 përqindësh. Zyrtarët e këtij koalicioni janë shprehur të bindur se me evitimin e parregullsive që po i shpërfaq procesi i rinumërimit të votave ky koalicion do të jetë pjesë e legjislaturës së shtatë të Kuvendit të Kosovës. Madje zyrtarët e të tri partive politike të koalicionit pretendojnë se nëse kalohet pragu prej pesë përqindësh secila do t'i ketë deputetët e vet në Kuvend

**EPOKA  
ERE****Muhamet KOÇI**

**PRISHTINË, 21 TETOR** - Procesi i rinumërimit të 530 vendvotimeve ka rritur gjasat e koalicionit Nisma-AKR-PD për ta kaluar pragun zgjedhor prej pesë përqindësh.

Zyrtarët e këtij koalicioni kanë bërë me dije se ky proces po tregon parregullsitë dhe manipulimet që janë bërë nga komisionarët partiakë në natën e 6 tetorit. Ata janë shprehur të bindur se korrigjimi i këtyre gabimeve do të bëjë që ky koalicion të jetë pjesë e Kuvendit të Kosovës.

Kryetari i Këshillit Kombëtar të Nismës Socialdemokrate, Jakup Krasniqi, ka deklaruar për gazetën "Epoka e re" se informacionet nga terreni tregojnë se koalicioni do ta kalojë pragun. "Të gjitha informacionet që po vijnë po tregojnë se Nisma, AKR e PD do të jenë pjesë e Kuvendit, ndonëse jo siç e kemi pritur. Ne e kemi pritur një rezultat tjetër, duke pasur parasysh ofertën tonë dhe parimet e socialdemokracisë, por në Kosovë nuk votohet as për programet politike e zgjedhore e as për programin ideologjik", ka

deklaruar Krasniqi. Sipas tij, ka pasur tentime të blerjeve të votave dhe deformim të rezulttit nga komisionarët. "Nga ajo që shihet, sovrani e ka kryer detyrën e vet mirë, ndërsa pak ka pasur tentime të blerjeve të votave e nga komisionarët deformim të rezulttit zgjedhor, sidomos në mes të kandidatëve ka pasur garë jokorrekte. Madje administrativisht ka pasur gabime jo të vogla, ku edhe KQZ-ja e ka përgjegjësinë e vet", është shprehur Krasniqi.

Edhe kryetari i Kuvendit të AKR-së, Fatmir Matoshi, është shprehur i bindur se koalicioni Nisma-AKR-PD do ta kalojë pragun zgjedhor pas rinumërimit të 530 vendvotimeve. "Koalicioni ynë ka kërkuar që të ketë rinumërim të tërësishëm të votave. Kjo kërkesë nuk është aprovuar. Megjithatë, KQZ-ja ka marrë vendim për rinumërim të disa kutive në komuna të ndryshme. Gjatë këtij rinumërimi po vërehen dhe po raportohen shumë parregullsi dhe dëmtime që i janë bërë koalicionit tonë. Korrigjimi i tyre patjetër se do të sjellë një rezultat më pozitiv për koalicionin AKR-NISMA-PD", ka thënë Matoshi. Ai ka pranuar se koalicioni ka pritur rezultat më të



mirë nga zgjedhjet e 6 tetorit. "Ne jemi të bindur se kemi qenë pjesë e Kuvendit edhe të dielën e 6 tetorit

bazuar në votat që janë në kuti të votimeve. Pavarësisht se koalicioni ynë do të jetë në Kuvend, më duhet

të theksoj se ky rezultat nuk ishte ai që prisnim ne si subjekte politike", ka deklaruar Matoshi.

## Të tri partitë pretendojnë se do të kenë deputetë në Kuvend

Zyrtarët e tri partive të koalicionit kanë bërë me dije se nëse kalohet pragu prej pesë përqindësh do t'i kenë përfaqësuesit e tyre në Kuvend. Nisma Socialdemokrate si parti më e madhe në këtë koalicion synon ta ketë numrin më të madh të deputetëve. Por edhe dy subjektet e tjera janë shprehur të bindura se do t'i kenë deputetët e tyre.

Kryetari i Kuvendit të AKR-së, Fatmir Matoshi, ka thënë për

"Epokën e re" se ky subjekt politik synon t'i ketë tre deputetë në Kuvend. "Në bazë të rezultateve që ne tani i kemi, presim që AKR-ja të përfaqësohet me tre deputetë në përbërjen e re të Kuvendit të Kosovës", ka bërë me dije Matoshi. Kurse sekretari i përgjithshëm i PD-së, njëherësh shef i shtabit Eroll Venhari, ka deklaruar se PD-ja është e shqetësuar me manipulimin e votave dhe se pret që pas

rinumërimit të jetë e përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës me një deputet. "Sipas informatave që i kemi nga terreni, kemi afër 5 000 vota të kandidatit tonë për deputet. Ne i kemi mbledhur të gjitha deklaratat e atyre të cilët na kanë votuar dhe që votat e tyre nuk kanë dalë. Ne po presim të përfundojë procesi i rinumërimit dhe t'i deponojmë ankesat tona në PZAP brenda afateve ligjore", ka thënë Venhari.

## Vitin e ardhshëm Japonia hap ambasadën në Prishtinë

**TOKYO, 21 TETOR (ER)** - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, është prituri nga Kryeministri i Japonisë, Shinzo Abe, në fillim të vizitës zyrtare në Japoni, ku do të marrë pjesë në ceremoninë e kurorëzimit të Perandorit Naruhito.

Presidenti Thaçi dhe kryeministri Abe në këtë takim kanë konfirmuar marrëdhëniet e mira bilaterale në mes dy vendeve.

Presidenti Thaçi i ka shprehur ngushëllime kryeministrit Abe edhe për viktimat e tajfunit të fundit. Ai është shprehur i kënaqur me avancimin e marrëdhënieve në mes dy vendeve. "Hapja e Ambasadës së Japonisë në Prishtinë në fillim të vitit të ardhshëm dhe samiti i suksesshëm i bizneseve nga Kosova,

Japonia e Austria në Vjenë, në fillim të këtij muaji, janë konfirmim i këtij avancimi", ka thënë presidenti Thaçi.

Kryeministri i Japonisë, Shinzo Abe, gjithashtu u shpreh i kënaqur me shtimin e bashkëpunimit dhe përkrahjen në mes dy vendeve. "Hapja e ambasadës sonë në Prishtinë, samiti i suksesshëm i bizneseve dhe Java e Kulturës Japoneze që do të mbahet muajin e ardhshëm janë konfirmim i afrimit tonë", u shpreh edhe kryeministri Abe.

Presidenti Thaçi shtoi se Kosova e përkrah kryeministrin Abe në politikat rajonale dhe për mbylljen e çështjeve të hapura si kidnapimi i qytetarëve japonezë nga Koreja Veriore.





Flet për "Epokën e re", Bajrush Xhemajli

# Qeveria e re nuk do ta ketë të

Nënkryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bajrush Xhemajli, ka thënë se zgjedhjet e 6 tetorit janë më të mirat që janë mbajtur deri më tani në Kosovë. Ai ka vlerësuar se rinumërimi i qindra vendvotimeve nuk e cenon procesin zgjedhor. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Xhemajli ka paralajmëruar se PDK-ja do të bëjë opozitë të fuqishme. Sipas tij, qeveria e re nuk do ta ketë të lehtë përballjen me PDK-në. Xhemajli ka thënë se propaganda e opozitës, koalicioni PAN dhe qëndrimi i gjatë në qeverisje kanë qenë faktorët që kanë penalizuar PDK-në në zgjedhjet e 6 tetorit. Megjithatë, ai ka theksuar se nuk janë ndarë keq me vota, pasi që kanë më shumë se në dy palë zgjedhjet e fundit

**EPOKA E RE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 21 TETOR -

**"Epoka e re":** Z. Xhemajli, si e vlerësoni procesin zgjedhor të 6 tetorit i cili po ballafaqohet me disa gabime teknike, në veçanti sa i përket numërimit të votave?

**Xhemajli:** Konsideroj se zgjedhjet e 6 tetorit kanë qenë prej zgjedhjeve më të mira që janë mbajtur deri më tani në Kosovë. Procesi zgjedhor ka qenë i rregullt dhe rinumërimi që po bëhet nuk e cenon tërësinë e tij. Rinumërimi është legjitim, por edhe ky rinumërim po tregon se, megjithatë, është votuar mirë. Pra, pas rinumërimit nuk ka pasur ndryshim radikal të rezultatit, edhe pse deri më tani

janë rinumëruar mbi 800 vendvotime.

**"Epoka e re":** Sipas këtij rinumërimi, është dëmtuar edhe PDK-ja, siç ishte rasti i fundit në një vendvotim në Lipjan, ku i janë mohuar 167 vota. Pse ka heshtje të zyrtarëve të PDK-së për këto gabime?

**Xhemajli:** Është e vërtetë se rinumërimi ka evidentuar pak shkelje duke marrë parasysh se në këtë proces të votimit kanë marrë pjesë mbi 800 mijë qytetarë. Çdo kund ka njerëz që e prishin procesin. Madje edhe në një dasmë ndodhin gjëra jo të mira e lërë më në një proces zgjedhor ku ka kaq shumë votues. Rinumërimet nuk mendoj se e prishin procesin, edhe pse këto gabime që kanë ndodhur nuk janë të mira.

## Nick Giacobbe emërohet zëvendësambasador i ShBA-së në Kosovë

PRISHTINË, 21 TETOR - Ambasadori amerikan në Prishtinë, Philip Kosnett, ka njoftuar se Nick

Giacobbe është emëruar zëvendësambasador në Kosovë. Përmes një njoftimi në llogarinë e vet në

"Twitter", Kosnett ka thënë se është i gëzuar për prezantimin e zëvendësit të ri. "Nick është një diplomat i

mençur dhe me përvojë, i cili bashkë me gruan e vet, Cory, është duke njohur shtetin dhe duke kontribu-

uar për fuqizimin e marrëdhënieve në mes të Shteteve të Bashkuara dhe Kosovës", ka shkruar Kosnett.



# Lehtë përballjen me PDK-në

Megjithatë, organet kompetente duhet të hetojnë nëse këto gabime janë bërë qëllimisht apo rastësisht.

**"Epoka e re":** *Ju po thoni se rinumërimi nuk ka ndikuar në përmbysje të rezultatit, megjithatë koalicioni Nisma-AKR-PD për një numër të vogël të votave është duke luftuar për ta kaluar pragun.*

**Xhemajli:** E kisha fjalën për rezultatin në mes të partive të para sepse rinumërimi ka mundësi që të ndryshojë diçka te ky koalicion dhe te kandidatët për deputetë, mirëpo nuk do të ketë ndryshim të madh. Megjithatë, procesi i rinumërimit është duke u monitoruar siç duhet nga vëzhguesit vendorë e ndërkombëtarë dhe kjo është e mirë, sepse nuk ka hapësirë për t'i mbetur hatri ndokujt.

**"Epoka e re":** *Sipas rezultateve preliminare të KQZ-së, PDK-ja ka dalë partia e tretë dhe do të jetë në opozitë. A ishte i prituri ky rezultat?*

**Xhemajli:** Kemi besuar se do të fitojmë edhe kësaj radhe, por nuk jemi ndarë keq me vota për faktin se pushteti të konsumon. Kemi qenë gjatë në qeverisje dhe, pavarësisht krejt punëve të mira dhe të mëdha që i kemi bërë, ka mundur të ketë edhe lëshime e gabime për të cilat, mbase, edhe jemi ndëshkuar! Por, në raport me zgjedhjet lokale i kemi diku mbi 13-14 mijë vota më shumë dhe kemi shumë më shumë vota sesa në zgjedhjet e fundit parlamentare. Elektorati na është hakmarrë për shkak të konkurrencës me PAN-in dhe na doli keq ky koalicion, sepse në zgjedhjet e 6 tetorit të vetëm arritëm gati votat e krejt PAN-it. Në fakt, PDK-ja në kuadër të PAN-it ka marrë shumë më pak vota. Në mandatin e fundit qeverisës, siç duket, nuk kemi arritur që të harmonizohemi në atë masë sa të ketë një qeverisje të mbarë dhe dorëheqja e z. Ramush Haradinaj tregoi se kjo nuk shkon më tutje.

**"Epoka e re":** *Cila mendoni se ka qenë arsyeja kryesore për humbjen e PDK-së?*

**Xhemajli:** Të gjithë u bënë kundër PDK-së dhe e gjithë ajo

propagandë sigurisht se ka pasur efektin e vet. Siç duket ka pasur efekt propaganda e orkestruar pothuajse që një dekadë, sidomos kjo në kohët e fundit. Natyrisht se në këtë rezultat ka ndikuar edhe bashkëqeverisja e PAN-it si dhe qëndrimi i gjatë në pushtet. Propaganda e opozitës, koalicioni PAN dhe qëndrimi i gjatë në qeverisje janë tre faktorët që na kanë penalizuar në një farë forme.

**"Epoka e re":** *Ju pas 12 vjetësh do t'i ktheheni Kuvendit e PDK-ja opozitës. Cili do të jetë roli i juaj në Kuvend dhe i PDK-së në opozitë?*

**Xhemajli:** Grupi Parlamentar i PDK-së do ta bëjë një punë profesionale dhe të organizuar mirë. Do të jemi opozitë e fuqishme e cila do të ngrehë zërin për çdo problem, prandaj qeveria e re nuk do ta ketë të lehtë përballjen me PDK-në. PDK-ja do ta ketë grupin parlamentar më të fortë dhe me kapacitete të duhura për të bërë opozitë të fuqishme, kështu që në thembër do të na kenë. Bazuar në rezultatin e deritanishëm, unë jam radhitur në dhjetëshen e parë të PDK-së, kam marrë mbi 11 mijë vota dhe jam i kënaqur me këtë rezultat. Prej marsit të vitit 2012 nuk jam pjesë e institucioneve të Kosovës, kurse në Kuvend po rikthehem pas 12 vjetësh. Jam i kënaqur sepse më 6 tetor më është dhënë një votë fisnike dhe kam ardhur këtu pa premtuar asgjë. Fushata ime ka qenë modeste dhe pa premtime, kush ka dashur të më votojë më ka votuar. Në fakt, asnjëherë kur kam qenë pjesë e garave nuk kam premtuar gjëra pa mbulese dhe vetëm sa për të marrë vota. Kam premtuar se do ta përfaqësoj denjësisht elektoratin tim në Kuvendin e Kosovës dhe për këtë jam i përgatitur dhe kam përvojë të mjaftueshme.

**"Epoka e re":** *PDK-ja do të jetë opozitë më e fuqishme sesa që ishte Vetëvendosja që pati përdorur edhe gazin lotsjellës?*

**Xhemajli:** PDK-ja nuk do t'i përsëritë skenat e gazit. Përdorimi i gazit ka qenë gabimi më i madh i rivalëve tanë në opozitë për faktin se kanë

përçuar një imazh tepër të keq të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Do të jemi shumë konstruktiv dhe me kompetencë do t'i ngrehim të gjitha problemet si dhe sigurisht se do t'ia dalim shumë shpejt për t'u rikthyer në qeverisje.

**"Epoka e re":** *PDK-ja do të jetë opozitë konstruktive dhe do t'i mbështesë proceset e rëndësishme për vendin?*

**Xhemajli:** Pa hile do të punojmë për Kosovën. Jam i bindur se çdo gjë që është në të mirë të Kosovës do ta aprovojme pavarësisht se kush e inicion, por do ta pengojmë çdo kënd që u bënë keq proceseve në Kosovë. Do të jemi aty për t'i çuar proceset përpara. PDK-ja e ka konceptin e vet opozitar dhe sigurisht se ai do të jetë më i mirë sesa i të gjithë të tjerëve.

**"Epoka e re":** *Si e komentoni formimin e qeverisë së re në mes të Vetëvendosjes dhe LDK-së?*

**Xhemajli:** Formimi i institucioneve po vonohet pa nevojë dhe kjo dukuri ka qenë edhe më herët. Pra, është dashur të pritët me muaj për konstituimin e Kuvendit dhe formimin e qeverisë. Uroj që rivalët tanë politikë të gjejnë gjuhë të përbashkët në këtë pikë dhe ta kemi sa më shpejt Kuvendin funksional dhe qeverinë e re.

**"Epoka e re":** *Z. Xhemajli, si do të jetë Kosova nën drejtimin e qeverisë Kurti?*

**Xhemajli:** Secilit duhet dhënë hapësirë kohore për të parë se çfarë do të bëjë meqë ka premtuar shumë. Ato që i kanë premtuar absolutisht nuk mund t'i realizojnë. Mendoj se nuk është mirë që të premtohet ajo që nuk realizohet dhe ata kanë premtuar gjëra të tilla.

**"Epoka e re":** *Qeverinë e re e presin shumë sfida, përfshirë këtu edhe procesin e dialogut. Mendoni se qeveria Kurti do të mund t'i finalizojë me sukses këto procese?*

**Xhemajli:** Uroj të bëhet siç kanë premtuar, sepse unë e dua më të mirën për Kosovën. Megjithatë, Vetëvendosja dhe LDK-ja janë parti të provuara në jetën tonë politiko-shoqërore. LDK-ja ka

bashkëqeverisur me ne, me Aleancën dhe brenda këtyre 20 vjetëve krejt pak nuk ka qenë pjesë e qeverisë dhe i është parë marifeti. Edhe Vetëvendosja nuk mund të thotë se nuk ka qeverisur për faktin se e ka qeverisur Prishtinën dhe bash asgjë nuk ka ndryshuar. Po ashtu, edhe në Prizren nuk ka qeverisur më mirë dhe nuk besoj se qytetarët janë të kënaqur me punën e Mytaher Haskukës. Madje mendoj se shumë më mirë kemi qeverisur ne se të gjithë të tjerët në Prizren dhe në Dardanë. Prandaj, një koncept i qeverisjes së tyre është parë, por ato çfarë kanë premtuar nuk i kanë realizuar. Si në nivelin lokal edhe në atë qendror e njëjta qeverisje është sepse janë njerëzit e njëjtë. Nuk do të doja që këta t'i zhgënjnë qytetarët, por jam i bindur se do t'i zhgënjnë.

**"Epoka e re":** *Po procesin e dialogut me Serbinë, si e shihni të udhëhequr nga kryeministri Kurti?*

**Xhemajli:** Dialogu asnjëherë nuk është i lehtë pavarësisht se për çfarë bëhet e lëre më për çështjet më të rëndësishme, siç është ai i Kosovës me Serbinë. Uroj që në këtë pikë të shkojnë punët mbarë sepse po të mos shkojnë mbarë do të humbet Kosova. Dialogu nuk është çështje e një partie, por është çështje shtetërore dhe këtu duhet të jemi sa më mirë. Mirëpo edhe këtu Albini do të shohë se sa vështirë është dhe se nuk do të mund të veprojë siç fliste në opozitë. Do ta ketë shumë të vështirë për ta finalizuar këtë proces dhe arritjen eventuale të marrëveshjes përfundimtare. Bisedimet kanë filluar moti dhe nuk mund të flasim për periudha të caktuara kohore, sepse edhe mund të arrihet shpejt marrëveshja, por edhe të mos arrihet as në këtë mandat. Ai do ta ketë të vështirë dhe e ka ditur këtë, megjithatë pushteti është i ëmbël dhe ka dashur që ta marrë me çdo kusht, madje duke premtuar edhe gjëra që nuk mund t'i realizojë. Ashtu siç i kanë premtuar gjërat nuk do të mund t'i realizojnë, megjithatë mbetet të shihet puna e tyre.

## Azem Syla ftohet për intervistim nga Gjykata Speciale

PRISHTINË, 21 TETOR - Ish-komandanti i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Azem Syla, është ftuar për intervistim nga Prokuroria e Specializuar për krime të luftës në Kosovë, me seli në Hagë. Lajmin e ka konfirmuar avokati i tij, Besnik

Berisha. Ai ka thënë se ende nuk dihen detajet se në çfarë cilësie është ftuar Syla nga Gjykata Speciale. Prokuroria e Specializuar, deri më tash,

ka ftuar për intervistim rreth 100 persona, ndër ta edhe disa nga ish-figurat e larta të UÇK-së, që pas luftës ishin dhe janë pjesë e skenës poli-

tike të Kosovës, sikurse Rrustem Mustafa, Sami Lushtaku, Shukri Buja, por edhe kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj.



## Një delegacion i policisë çeke viziton Kosovën

PRISHTINË, 21 TETOR (ER) - Një delegacion i lartë i Policisë së Çekisë po qëndron për vizitë zyrtare në Policinë e Kosovës, përkatësisht në Departamentin e Kufirit si dhe në disa dikastere të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Kjo vizitë filloi me pritjen zyrtare të realizuar të hënën në ambientet e Drejtorisë

së Përgjithshme të PK-së ku zëvendësudrejtori i përgjithshëm për Operativë, Samedin Mehmeti, i shoqëruar nga zyrtarë të Departamentit të Kufirit, pritën zyrtarët nga Republika e Çekisë, me të cilët diskutuan për avancimin e mëtejme të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve. Ndër të tjera, u

diskutua edhe rreth programit "Bashkëpunimi për zhvillimin e sigurisë" si dhe për projekte të tjera që janë me interes të përbashkët policor. Takime dhe vizita të delegacionit do të realizohen edhe në dikastere pranë MPB-së, në Aeroport, Pika Kufitare dhe lokacione të tjera që janë paraparë si pjesë e vizitës.



## Komandanti i FSK-së nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Norwichit



PRISHTINË, 21 TETOR (ER) - Komandanti i FSK-së, gjeneral-allejtënant Rrahman Rama, më 17 tetor, në kuadër të vizitës zyrtare në ShBA, ka vizituar Universitetin e Norwichit në Vermont. Gjeneral Rama në emër të Ministrisë së Mbrojtjes ka nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi me Universitetin e Norwichit për të

bashkëpunuar në fushën e edukimit, hulumtimit shkencor në fushën ushtarake, si dhe garave në mes të kadetëve të këtyre institucioneve.

Pas nënshkrimit të këtij memorandum, gjeneral Rama e ka falënderuar presidentin e këtij institucioni, Richard Schneider, për besimin dhe mundësinë e dhënë, duke

theksuar se ky bashkëpunim do të kontribuojë për avancimin e njohurive dhe përvojave të kadetëve të të dy institucioneve.

Me një traditë 200-vjeçare, Universiteti i Norwichit, i cili njihet edhe si Kolegji Ushtarak i Vermontit, konsiderohet të jetë institucioni ushtarak më i vjetër në ShBA. Me një staf

mjaft profesional dhe me një përvojë të jashtëzakonshme, qëllimi i këtij kolegji është që t'i edukojë dhe t'i trajnojnë kadetët e rinj për të qenë liderë të ushtrisë amerikane. Realizimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi pritet të fillojë në vitin 2020.

Gjeneral Rama së bashku me delegacionin e vet, i përbërë

nga kolonel Ilir Qeriqi, atashë i Mbrojtjes në ShBA, major Korab Dauti në ShPFK dhe major Jaser Mulla, asistent ushtarak i KOMFSK-së, patën rastin ta vizitojnë edhe Qendrën Trajnuese për Mbrojtje Kibernetike, nga stafi i së cilës janë njoftuar për funksionimin dhe mbarëvajtjen e procesit të saj mësimor.

## Shkolla "Naim Frashëri" së shpejti me ngrohje qendrore nga Termokosi

PRISHTINË, 21 TETOR - Zyra e Bashkimit Evropian (BE) në Prishtinë ka organizuar një vizitë në shkollën "Naim Frashëri", e cila së shpejti do të lidhet me rrjetin e ngrohjes qendrore të ofruar nga Termokosi.

Shqipe Vllasaliu-Mehmeti, drejtoreshë e shkollës "Naim Frashëri", ka falënderuar Komisionin Evropian për investimin në këtë shkollë si projekt i shtrirë në tërë lagjen. "Jemi mbledhur këtu për t'i inauguruar këto ambiente të mira për nxënësit tanë. Për realizimin e vizionit tonë pretendojmë një shkollë mike me standarde evropiane, ku kontributi juaj na

shpie në atë rrugë. Jemi shkollë multikulturore dhe në shkollën tonë, përveç gjuhës shqipe, mësimi mësohet edhe në gjuhën boshnjake, e kjo na bënë më të veçantë", ka thënë ajo.

Shefi i Operacioneve në Zyrën e Komisionit Evropian në Kosovë, Luigi Brusa, ka pohuar se ky projekt është shumë i rëndësishëm dhe se ndikon edhe në mbrojtjen e mjedisit nga emetimi i gazrave të dëmshëm. "Ky është një projekt i rëndësishëm rreth 6 milionë euro dhe nuk përfshin vetëm këtë shkollë, por edhe shumë ndërtesa përreth. Po

përdorim ngrohjen prej Termokosit dhe po e reduktuam përdorimin e thëngjillit", ka thënë Brusa.

Arsim Fetahu, drejtor i Termokosit, ka theksuar se ky projekt nuk do të ishte i mundur pa ndihmën e BE-së. Ai ka paralajmëruar shtrirje të rrjetit edhe në lagjet e tjera. "Ky projekt nuk do të ishte i mundur pa ndihmën e Komisionit Evropian. Në mesin e këtyre katër konsumatorëve, përfshirë shkollën 'Naim Frashëri', projekti do të vazhdojë në shumë pjesë të qytetit. Pjesa më e madhe e këtij projekti do të bëhet në lagjen Kalabria.



Shpresojmë se deri në muajin nëntor 2 000 konsumatorë do të kyçen", ka thënë ai.

Shpresa Shala, drejtoreshë e Arsimit në Komunën e Prishtinës, ka theksuar se

përmes këtij projekti nuk po mbrohen vetëm fëmijët, por edhe familjet e tyre. Ajo shprehet të jenë prioritet shkollat dhe çerdhet nga ana e Termokosit për zgjerimin e rrjetit.



# Fotografia brenda shkollës me flamurin turk dhe me përshëndetje ushtarake sjell reagime të shumta

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 21 TETOR - Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT), Komuna e Prizrenit, Këshilli i Prindërve të Kosovës dhe Qendra Rajonale e Këshillit për Mbrojtjen e Drejtave e të Lirive të Njeriut në Prizren, kanë reaguar ndaj rastit i cili është paraqitur në media, ku shihet një person i rritur (që besohet të jetë mësimitdhënës) dhe disa fëmijë në një shkollë në Prizren, me flamurin e shtetit turk duke bërë përshëndetje ushtarake. "Shkollat nuk janë hapësira për aplikimin e asnjë lloji ideologjie dhe abuzimi në këtë formë me fëmijët është në kundërshtim me konventat ndërkombëtare dhe me ligjet e aplikueshme në Kosovë. Prandaj, MASHT-i gjatë ditës së sotme do t'i dërgojë inspektorët e arsimit në shkollën në fjalë për të marrë informacione zyrtare rreth këtij rasti, në mënyrë që të kenë informata të sakta për ta adresuar këtë rast dhe për të marrë masa ndaj përgjegjësve", thuhet në reagimin e MASHT-it. MASHT-i ka ftuar mësimitdhënësit, nxënësit, prindërit dhe gjithë komunitetin, që të reagojnë dhe ta paraqesin çdo rast të abuzimit me fëmijët, "sepse vetëm në këtë mënyrë do të mund t'i mbrojmë fëmijët tanë nga çdo lloj rreziku që iu kanoset".

Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren ka bërë me dije se këtë rast është duke e shqyrtuar hollësisht dhe është në koordinimin të plotë me Inspektoratin e Arsimit për mbledhjen e informacioneve nga terreni. "Këto ditë nëpërmjet rrjete sociale dhe media është publikuar një fotografi ku shi-



hen nxënësit e shkollës ShFMU 'Motrat Qiriazit' dhe mësimitdhënësi i kësaj shkolle, e cila ka shkaktuar reagim në opinion, me pretendim për abuzim ndaj fëmijëve. Në momentin e kompletimit të të gjitha informacioneve, DKA do t'i marrë masat e parapara sipas legjislacionit në fuqi. Me këtë rast DKA thekson se në hapësirat shkollore nuk është i lejuar aplikimi i asnjë lloji ideologjie dhe abuzimi me fëmijë dhe iu bën thirrje të gjithë mësimitdhënësve që të jenë vigjilentë dhe të

kujdesshëm për respektimin e ligjeve dhe të drejtave të fëmijëve", është thënë në reagimin e Komunes së Prizrenit.

Këshilli i Prindërve të Kosovës ka reaguar në lidhje me këtë rast. Ai këtë veprim e konsideron të papërgjegjshëm nga ata që kanë manipuluar me nxënësit dhe ka bërë thirrje të secili qytetar i cilësdo përkatësie etnike, që të mos manipulojnë me nxënësit për interesa çfarëdo qofshin ato. "Nxënësit shkollën e kanë vend edukimi e arsimit, asgjë më shumë.

Prandaj Këshilli i Prindërve të Kosovës u bënë thirrje institucioneve përgjegjëse që t'i ndër-marrin masat që i parasheh ligji", thuhet në reagimin e këtij Këshilli.

Ndërkaq Qendra Rajonale e Këshillit për Mbrojtjen e Drejtave e të Lirive të Njeriut në Prizren ka shprehur indignatën e thellë për këtë gjest. "KMDLNj konsideron se ky gjest jo vetëm se është keqpërdorim i fëmijëve dhe rreshtim i padrejtë ndaj një partie politike në një vend jashtë Kosovës, por patjetër që

është edhe i dënueshëm. Me këtë rast u bëjmë thirrje organeve të shtetit ta zbardhin këtë rast dhe të përfshirët në këtë incident të rëndë të ndëshkohen konform ligjeve të Kosovës. KMDLNj u bënë thirrje, pos organeve të hetuesisë, edhe MASHT-it e DKA-së në Prizren që të marrin masa urgjente që ky incident, ku keqpërdoren fëmijët hapur, ta marrë ndëshkimin e merituar. Me forcë të ndalet ky politizim", është theksuar në reagimin e KMDLNj-së në Prizren.

## Zarfet nga Serbia, lirohen nga spitali 12 pacientët



PRISHTINË, 21 TETOR - Dymbëdhjetë pacientët e shtrirë në Klinikën Infektive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, që kanë kërkuar ndihmë mjekësore pasi që janë ankuar për reaksione alergjike teksa po verifikonin zarfet me vota të ardhura nga Serbia janë liruar nga spitali, kanë bërë me dije zyrtarë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës.

Ushtruesja e detyrës së drejtoreshës së Klinikës Infektive, Linda Ajazaj-Berisha, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se

pacientët janë liruar nga spitali në gjendje të mirë shëndetësore. "Gjendja shëndetësore, në momentin kur i kemi liruar pacientët, ka qenë e mirë. Ne i kemi përjashtuar sëmundjet apo shkaktarët infektivë. Me të tjerat mbetet të merren organet e tjera të hetuesisë që kanë filluar procedurat", ka thënë Ajazaj-Berisha.

Të dielën, më 13 tetor, teksa po hapnin dhe verifikonin votat e ardhura nga Serbia në zarfet e mbyllura, fillimisht kanë qenë 20 zyrtarë të Komisionit

Qendror të Zgjedhjeve që janë ankuar për gjendjen shëndetësore dhe më pas 12 prej tyre kanë përfunduar të shtrirë në spital.

Prokuroria e Kosovës po i vazhdon hetimet pas raportimeve se te këta persona janë shfaqur reaksione alergjike pas hapjes së këtyre zarfeve. Mostrat e zarfeve me votat nga Serbia, sipas Prokurorisë së Kosovës, kanë përfunduar për ekzaminim në një laborator të një shteti evropian, por nuk tregohet se në cilin vend.



## Kosova nënshkruan marrëveshjen për eliminimin e tatimit të dyfishtë me Arabinë Saudite

PRISHTINË, 21 TETOR (ER) - Ministri në largim i Financave, Bedri Hamza, në kuadër të vizitës së tij zyrtare në Uashington, së bashku me ministrin e Financave të Arabisë Saudite, Mohammed Al-Jadaa, kanë nënshkruar marrëveshjen për eliminimin e tatimit të dyfishtë ndërmjet Kosovës dhe Arabisë Saudite. Sipas ministrit Hamza, kjo marrëveshje do të jetë një akt ligjor që do të përfitojnë qytetarët dhe bizneset e të dy vendeve, njëherësh është një mjet shtesë ligjor për të motivuar dhe përfituar investime të huaja në vendin tonë. Ministri Hamza gjatë vizitës në Uashington gjithashtu u takua edhe me zyrtarët e lartë të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Bankës Botërore, duke përfshirë takimin me zëvendës-drejtorin ekzekutiv të Fondit Monetar Ndërkombëtarë Tao Zhan, me zëvendës-drejtorin e Fondit Monetar Ndërkombëtar për Evropë Poul Thomsen, me

zëvendës-drejtorin e bankës Botërore për Evropë dhe Azinë Qendrore Cyril Muller, si dhe me drejtoreshën e Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor Linda Van Gelder. Me këtë rast, ministri Hamza i njoftoi përfaqësuesit e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore për stabilitetin makro-fiskal dhe zhvillim ekonomik të Kosovës, si dhe për planet për të ardhmen.

Ndërsa zyrtarët e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore e përgëzuan ministrin Bedri Hamza për përpunimin e deritanishëm financiar dhe ekonomik të Kosovës, që si rezultat i kësaj Republika e Kosovës tashmë është në top 20 reformatorët më të mëdhenj të Doing Business për këtë vit në raportin e Bankës Botërore. Ata, gjithashtu, konfirmuan mbështetjen e mëtutjeshme për Ministrinë e Financave, por edhe për institucionet e tjera në vend.



## Përmes rritjes së pagës minimale synohet të ruhet fuqia punëtore në Maqedoninë e Veriut



SHKUP, 21 TETOR - Afaristët në Maqedoninë e Veriut theksojnë se rritja e pagës minimale është më se e nevojshme për ta mbajtur në vend krahun e punës, megjithëse theksojnë se me shumë rëndësi është që sa më parë në politikat e qeverisë të orientohen për rritjen e produktiviteti të punëtorëve. Pushteti, punëdhënësit dhe sindikata kanë rënë dakord që nga dhjetori paga minimale në vend të jetë 14.500 denarë (rreth 235 euro), përkatësisht ajo të rritet për 2 mijë denarë (rreth 35 euro).

Oda e Maqedonisë Veri-perëndimore, e cila e ka mbështetur masën e qeverisë për rritjen e pagës minimale, kërkon që politikat e shtetit të orientohen edhe në rritjen e produktivitetit të punëtorëve.

Drilon Iseni, drejtor i Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-perëndimore, për "Radion Evropa e Lirë" thotë se rritja e pagave duhet të jetë në korrelacion me produktivitetin e punëtorëve. "Vlerësojmë se si masë e përkohshme, mirëpo në një fazë afatgjatë, gjithçka do të bie si barrë në kurriz të biznesit.

Bizneset për t'i motivuar punëtorët, veçanërisht të rinjtë që të japin rezultate më të mira, të jenë më produktiv me rezultate më të mira në punë, duhet të investojnë në këtë drejtim. "E vërteta është se kompanitë të cilat ne i përfaqësojmë si Odë në shkallë të madhe kanë nisur të profesionalizohen në biznese profesionale, do të thotë se një pjesë të buxhetit e kanë të paraparë për ngritjen e kapaciteteve duke i çuar në trajnime të ndryshme punëtorët e tyre", ka theksuar Iseni, duke nënvizuar se në këtë drejtim duhet të orientohen për ngritjen

e kapaciteteve për aftësimin dhe profesionalizimin e krahut të punës duke pasur për bosht institucionet arsimore.

Përderisa qytetarët thonë se rritja e pagës minimale prej 2 000 denarë nuk do të ketë ndonjë impakt të dukshëm pozitiv për ngritjen e cilësisë së standardit jetësor, punëdhënësit drujnë se rritja e pagës minimale do të çojë në mbylljen e kompanive të vogla për shkak të problemeve me sigurimin e fitimit.

Nga organizata e punëdhënësve kanë theksuar se jo çdo kompani do të jetë në gjendje ta paguajë

pagën minimale në vlerë prej 14.500 denarësh, duke paralajmëruar mbylljen e disa ndërmarrjeve më të vogla, kryesisht ato që janë pjesë e industrisë së tekstilit. "Tani ka informacione se në Manastir janë mbyllur tri kompani të vogla sepse nuk po arrijnë ta sigurojnë pagesën e pagës minimale. Në këtë formë më duhet të theksoj se goditen kompanitë e vogla, ndërkohë që dihet se boshti më i rëndësishëm që e vë në lëvizje zhvillimin e ekonomisë janë pikërisht ndërmarrjet e vogla dhe ato të mesme", ka thënë për "REL" Marijana Petkoska nga sektori i tekstilit.

Nga ana tjetër, në bazë të një analize të Institutit për Kërkime Ekonomike "Finance Think" kompanitë e vendit kanë kapacitet të përballojnë një rritje të pagës minimale vetëm për 1 000 denarë, përkatësisht ajo të jetë 13 mijë e 500 denarë, duke shtuar se rritja e pagës duhet të bëhet mbi bazë të produktivitetit të punës dhe potencialin e ekonomisë e në asnjë mënyrë kjo rritje të mos jetë artificiale.

Edhe opozita maqedonase VMRO DPMNE ka kritikuar rritjen e pagës minimale, duke theksuar se nuk është kundër që punëtorët të marrin paga më të larta por, siç e kanë quajtur, kjo masë nuk është e papërbalueshme për "ekonominë e gjuhëzuar të vendit nga keqqeverisja aktuale".

Në Maqedoninë e Veriut rreth 100 mijë të punësuar marrin pagë minimale.



# Ambasadat gjermane përgatiten për fluksin e vizave



Shumë veta nga Shqipëria e Kosova që kërkojnë një vizë pune realisht duhet të kenë durim për shkak të pritjes së gjatë në ambasadat gjermane. Ministria e Jashtme e Gjermanisë ka njoftuar se do të ketë përmirësime në këtë drejtim

**PRISHTINË, 21 TETOR** - Deri më tani disa qindra mijëra punëtorë nga vendet e Ballkanit Perëndimor kanë ardhur në Gjermani të punojnë përmes Rregullores së Ballkanit të qeverisë gjermane. Nga ekspertët ajo shihet si sukses i madh që po përmbush nevojat e tregut gjerman të punës. Sipas Institutit të Ekonomisë Gjermane (IW), në fillim të këtij viti kanë qenë të regjistruar afër 100 000 veta nga vendet e Ballkanit Perëndimor që punojnë në punë të thjeshta në Gjermani dhe 60 000 të tjerë që kanë gjetur punë të kualifikuara. Por kjo rregullore e posaçme e qeverisë gjermane, e cila u ofrua si mundësi për ta reduktuar

numrin e refugjatëve nga vendet e Ballkanit në vitin 2015, përfundon në vitin 2020. Më 1 mars 2020 pritet të hyjë në fuqi ligji gjerman për fuqinë punëtore, i cili rregullon në hollësi ardhjen e fuqisë punëtore nga vendet jashtë BE-së. Për herë të parë mund të vish në Gjermani edhe me një vizë gjashtëmujore për të kërkuar punë duke i mbuluar personalisht shpenzimet për këtë periudhë. Përveç kësaj, të rinjtë nën moshën 25 vjeç që kanë mbaruar shkollën mund të vijnë për të kërkuar një vend kualifikimi për deri në gjashtë muaj, nëse matura e tyre i kualifikon për shkollë të lartë, nëse njihin gjermanishten

në nivelin B2 dhe e sigurojnë vetë jetesën në këtë kohë.

## Kritika për kohëzgjatjen e vizës

Ligji tingëllon si një premtim i bukur, por si do të arrish deri te marrja e vizës? Sepse megjithëse Gjermania po ndjek një politikë të hapur në drejtim të sigurimit të fuqisë punëtore nga jashtë, realisht rruga e ardhjes si punëtor i rregullt në këtë vend është shumë e gjatë. Viza është kthyer në pengesën kryesore për ardhjen në kohë të fuqisë së kualifikuar punëtore për sipërmarrjet gjermane. Deri në një vit e më shumë presin aplikuesit për vizë vetëm për marrjen e një orari për futjen e dokumenteve në ambasadat gjermane në vendet e Ballkanit. Dhoma Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë (DIHK) e ka kritikuar së fundmi fenomenin e tejzgjatur të pritjes për vizë. Ekonomia gjermane ka pritshmëri të larta nga

ligji për ardhjen e fuqisë punëtore, thuhet nga ky institucion. Shumë firma kanë probleme të gjejnë fuqi punëtore. Prandaj DIHK kërkon që "qëllimi duhet të jetë shkurtimi i kohës së pritjes për një orar në ambasadë dhe marrjen e vizës nga sa është tani një vit deri në disa javë", citon gazeta gjermane "Frankfurter Allgemeine Zeitung", DIHK. Sipas presidentit të DIHK, Erich Schweitzer, "sipërmarrjet e këtushme janë të varura nga ajo që nga viti 2020 të ketë vërtet procedura të përsheptuara në rekrutimin e fuqisë punëtore nga vendet jashtë BE-së". Këto shqetësime të Dhomës Gjermane të Tregtisë përkojnë me raportimet në media, se në vitet e ardhshme pritet ulje e fuqisë punëtore nga vendet e BE-së. Ligji për fuqinë e kualifikuar punëtore e parashikon edhe procedurën e përsheptuar për fuqinë punëtore, nëse kjo kërkohej nga punëdhënësi.

"Deutsche Welle" ka pyetur Ministrinë e Jashtme Gjermane, se çfarë përgatitjesh po bëhen për përbalimin e fluksit të mundshëm të kërkesave për vizë nga 1 janari 2020, kur hyn në fuqi ligji për fuqinë e kualifikuar punëtore. Zyra e shtypit ka reaguar me një deklaratë ku thekson se "Ministria e Jashtme, së bashku me aktorët e tjerë të përfshirë në procesin e vizës, po përgatitet intensivisht para hyrjes në fuqi të ligjit për fuqinë e kualifikuar punëtore. Qëllimi i masave të ndryshme janë përmirësime të tjera në drejtim të eficientës dhe mirësjelljes ndaj aplikuesve në procesin e vizës kjo përmes zgjerimit të kapaciteteve, digjitalizimit të mëtejshëm dhe masave konkrete për zvogëlimin e procesit administrativ në procedurën e marrjes së vizës".

Shumë aplikues për një vizë pune në ambasadat gjermane në Tiranë dhe Prishtinë ankohen për procedurat e gjata që rrezikojnë edhe vendin e punës që ata kanë arritur të gjejnë në Gjermani. Një nga kërkesat për marrjen e vizës që merr shumë kohë është njohja e kualifikimit profesional. Sipas Zyrës së Shtypit të Ministrisë së Jashtme Gjermane, si rregull kërkohej që të interesuarit të kenë një njohje zyrtare të profesionit e menjëherë pas kësaj mund të kërkojnë vizë. Tani planifikohet të ngrihet një zyrë qendrore shërbimi për fuqinë punëtore që kërkon njohjen e kualifikimit. "Kjo qendër shërbimi do t'i këshillojë aplikuesit në vendet ku janë dhe do t'i shoqërojë ata në procedura përkatëse", thuhet nga Ministria e Jashtme gjermane.

Por nëse këto masa do të japin efekt konkret për shkurtimin e kohës së pritjes për marrjen e vizës, këtë do ta tregojë viti i ardhshëm. DIHK gjermane ka kërkuar nga qeveria gjermane që ta rrisë personelin në ambasadat gjermane dhe t'i krijojë kushtet për marrjen e fuqisë së kualifikuar punëtore nga jashtë.

## Tre ish-drejtuësit e Telekomit lirohen nga akuzat lidhur me kontratën me 'Z-Mobile'

**EPOKA  
ERE**

**A. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 21 TETOR** - Tre ish-drejtuësit e Postës dhe Telekomit të Kosovës (PTK), tash Telekomit i Kosovës, Agron Mustafa, Ejup Qerimi dhe Rexhë Gjonbalaj, janë liruar të hënën nga akuza për keqpërdorim të pozitës zyrtare lidhur me kontratën me 'Z-Mobile'. Në rastin e njohur si "Posta", ata akuzoheshin për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar pasi pretendohet se i kishin shkaktuar Telekomit të Kosovës humbje afro 30 milionë euro lidhur me kontratën me 'Z-

Mobile'. Sipas kryetarit të trupit gjykues, gjykatësi Lutfi Shala, ky trup gjykues nuk gjen se të akuzuarit kanë kryer veprën penale. Ai ka thënë se pas dëgjimit të dy të dëmtuarve, dëshmitarëve dhe provave materiale, nuk është vërtetuar pretendimi i Prokurorisë Speciale. "Vërtetohet se ndërmyjet dy kompanive PTK dhe 'Z-Mobile' është lidhur një kontratë. Të gjitha veprimet e ndërmyra nga palët kontraktuese gjykata ka pretenduar se këto veprime janë ndërmarrë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që i kanë pasur të dyja palët, por pasi të dyja palët kanë pasur

pretendime të ndryshme lidhur me kontratën, palët i janë drejtuar ARKEP-it, i cili ka marrë vendim me të cilin është obliguar PTK-ja që ta rezervojë numeracionin 457, ku gjykata ka vërtetuar se PTK-ja ka ndarë këtë numeracion për 'Z-Mobile'. Për gjykatën nuk paraqet asnjë element të veprës penale 'keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar', ka deklaruar gjykatësi Shala me rastin e shpalljes së aktgjykimit. Lidhur me këtë rast Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), më 17 gusht 2018 kishte ngritur aktakuzë ndaj Ejup Qerimit, Agron



Mustafës dhe Rexhë Gjonbalajt, me pretendimin se të njëjtit kishin kryer veprën penale

"keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar", nga neni 422 i KPRK-së.



## Gjilani ka mungesë të punëtorëve në pozita të rëndësishme

**GJILAN, 21 TETOR (ER)** - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, në mbledhjen e bordit të drejtorëve e cila është transmetuar drejtpërdrejt nga mediat, ka deklaruar se së shpejti pritet të ndodhë rishikimi funksional i 12 udhëheqësve të dikastereve përkatëse. Në këtë takim drejtorët komunalë dhe shefat e zyrave dhe njësisve kanë raportuar për nëntëmujorin e punës, për arritjet, sfidat dhe problemet. "Gjatë kësaj periudhe kemi realizuar dhe janë në realizim projekte infrastrukturore e fushat e tjera në vlerë prej dhjetëra miliona eurosh. Zgjedhjet kanë afektuar

disa projekte, por nuk jemi ndalur asses. Lajmi i mirë është që është shpallur oferta publike e rrugës katër korsi prej 7.2 kilometrash, Gjilan-Penda e Livoçit. Do t'i vazhdojmë investimet në rrugën Gjilan-Bujanoc, në rrugën e Kumanovës, në rrugën prej Livoçit të Ulët në drejtim të Kllokotit dhe rrugët e tjera që janë pjesë e investimeve. Pastaj, përfundimi i rregullimit të lumit Mirusha, Tregut të Gjelbër dhe punimet te stadiumi i qytetit janë projekte që eliminojnë nevojën e qarkullimit me vetura", ka thënë Haziri.

Një projekt tepër i rëndësishëm i



cili do të realizohet në vitin e ardhshëm, i pari i gjilanasve ka

thënë se është ai i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza, me

kosto rreth 30 milionë euro. Kryetari Haziri ka thënë se as pas tri vjetësh të suspendimit të 30 zyrtarëve komunalë si pasojë e një aktakuzë për krim të organizuar, akoma nuk kemi epilog nga organet e drejtësisë. "Si pasojë e kësaj, Gjilani vazhdon ta vuajë traumën e 'Palermos', pasi që po duhet shumë angazhim për t'i bindur donatorët për mbështetje. Si rrjedhojë e kësaj, kemi mungesë të punëtorëve në pozita vakante dhe deri në fjalën përfundimtare të drejtësisë nuk mund të angazhohet punëtorë me kontratë afatgjatë të shërbimit civil", ka thënë Haziri.

## 10 mijë fidanë do të mbillen në Deçan



**DEÇAN, 21 TETOR (ER)** - Deponitë ilegale të krijuara në Komunën e Deçanit tashmë janë larguar dhe këto hapësira do të kthehen në gjelbërim. Kryetari i kësaj komune, Bashkim Ramosaj, ka bërë me dije se 10 000 fidanë të rinj do të mbillen. Ai ka thënë se brenda kësaj jave do të nisë edhe aksioni i mbjelljes së këtyre fidanëve kryesisht pishë, që janë siguruar nga Agjencia Pyjore e Kosovës. "Ne si institucion komunal kemi arritur që falë punës me përkushtim të

Ndërmarrjes Komonale 'Higjiena', po ashtu edhe kompanive private të cilat në mënyrë vullnetare na kanë ndihmuar, t'i mbyllim deponitë ilegale të krijuara në disa fshatra të Komunës së Deçanit, ndërsa tashmë këto hapësira do t'i pyllëzojmë. Kjo do të bëhet e mundshme duke bashkëpunuar edhe me banorët e fshatrave ku do ta bëjmë pyllëzimin", është shprehur Ramosaj, duke shtuar se mbjellja e fidanëve do të nisë në fshatrat Llukë e Epërme,

Llukë e Ulët, Isnig, Baballoq, Prapaqan, ku do të pyllëzohet edhe vendi i quajtur "Podi i Gështenjave". "Nga ky aksion do të përfitojë komuniteti i cili jeton në këta fshatra", është shprehur Ramosaj.

Ky projekt do të implementohet nga Ndërmarrja Komonale "Higjiena", institucioni komunal, Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtje dhe Shpëtim, Drejtoria e Bujqësisë dhe banorët e atyre fshatrave ku do të bëhet pyllëzimi.

## Nxënësit e Kamenicës, pjesë e programit 'Fuqizimi përmes lojës'

**KAMENICË, 21 TETOR (ER)** - Organizata joqeveritare "Play2EDUCATE (P2E)" në bashkëpunim me Drejtorinë Komonale të Arsimit në Kamenicë kanë realizuar programin pesëjavësh "Fuqizimi përmes lojës". Ky program ka përfunduar me nxënësit e shkollave të mesme të Komunës së Kamenicës: Gjymnazi "Ismail Qemali", Shkollë Teknike "Andrea Durrsaku" dhe Gjymnazi "Sejdi Kryeziu" Roganë. Programi ka pasur për qëllim zhvillimin e mendimit kritik rreth temave të ndryshme si: barazja gjinore, të drejtat e njeriut, zgjidhja e konflikteve, gjithëpërfshirja etj. Ushtruesja e detyrës së drejtoreshës Komonale të Arsimit, Mirhane Morina, ka



thënë se është shumë e lumtur që nxënësit të Kamenicës po u ofrojnë mundësi të tilla. "Ne jemi shumë të lumtur që po arrijmë t'u ofrojmë mundësi të tilla fëmijëve tanë. Do të angazhohemi vazhdimisht që të realizojmë programe të tilla nga të cilat do të përfitojnë nxënësit", ka thënë ajo.

## GAC ndihmon jetësimin e modelit për riciklim në Kosovë

**PRISHTINË, 21 TETOR (ER)** - Green Art Center (GAC) në vazhdimësi implementon aktivitete në kuadër të projekteve me donatorë të huaj, me fokus përmirësimin e kushteve mjedisore dhe që stimulojnë zhvillimin e ekonomisë qarkore në vend. Në vitet e fundit, në partneritet me Gizin German, "Projekti për shërbime të qëndrueshme komunale" ka nisur zbatimin e projekteve që synojnë ndarjen e mbeturinave të ricikluar në funksion të zhvillimit të ekonomisë qarkore në nivel vendi dhe ku në pilotimet e para janë bërë planifikimet e këtij procesi dhe analizuar lagjet pilotë në qytetet si:



Prishtinë, Vushtrri, Drenas, Mitrovicë, Fushë Kosovë, Gjakovë dhe Prizren. Përpos Komunës së Prishtinës që do ta nisë pilotimin për riciklim në një fazë të radhës, qytetet e tjera kanë nisur zbatimimin e projekteve për ndarjen në burim për mbeturina të ricikluar.

## Aksioni për largimin e kioskave pa leje do të vazhdojë në Mitrovicë

**MITROVICË, 21 TETOR (ER)** - Drejtuar nga nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, është mbajtur mbledhja e radhës e Bordit të Drejtorëve, në të cilën janë diskutuar disa pika të rendit të ditës që janë me interes për qytetarët e Komunës së Mitrovicës. Fillimisht drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, Tafil Peci, e ka njoftuar bordin rreth organizimit të Panairit të Sportit, i cili do të mbahet

nesër, më 22. 10. 2019, duke filluar nga ora 10:00, në Sheshin "Isa Boletini", me ç'rast është konfirmuar edhe pjesëmarrja e shumicës së klubet sportive të qytetit të Mitrovicës.

Ndërsa nga Drejtoria e Inspeksionit, Vehbi Ahmeti, lidhur me largimin e tri kioskave të vendosura në afërsi të objektit të komunës, ka theksuar se aksionet e tilla do të vazhdojnë edhe në ditët në

vijim, për të gjitha ato kioska të cilat ushtrojnë veprimtaritë e tyre pa leje nga organi kompetent. Po ashtu, ai tha se edhe gjatë kësaj fundjave inspektorët komunalë në bashkëpunim me Policinë e Kosovës kanë inspektuar subjektet afariste lidhur me vendimin për respektimin e orarit të punës. Në këtë takim Bordi ka diskutuar edhe për një sërë temash që ndërliken me mirëqenien e qytetarëve.





# Shengeni serbo-centrik ose Ballkani midis euroatlantizmit dhe Euro-Azisë



**Prof. Lisen BASHKURTI**

Schengeni ballkanik, i firmosur pak ditë më parë nga Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria, do të shfrytëzohet nga Serbia dhe Rusia si një paradhomë për ta rrëshqitur Ballkanin Perëndimor drejt Unionit Euro-Aziatik me Rusinë në krye. Kjo lëvizje alarmante buron nga vetë përmbajtja strategjike e Shengenit serbo-centrist trepalësh, që është as më shumë dhe as më pak një ide e vjetër me mbulesa të reja, është një doktrinë ruso-serbe me terminologji europerëndimore, pra është mballopë perëndimore në thesin e shqyer të muzhikut rus.

## 1. Shengeni serbo-centrist injoron MSA-n dhe shengenin evropian

Thelbi i shengenit ballkanik serbo-centrik nuk mund të krijohet kurrfarë federate jugosllave në Ballkan, as me doktrinën e vjetra dhe as me termat e reja, as me gjuhë diplomatike të MSA-së dhe as me modele Shengeni evropian. MSA-në e kanë firmosur dhe ratifikuar treshja Shqipëri, Serbi dhe Maqedoni e Veriut, të cilat janë edhe pjesë e marrëveshjes së Shengenit. Si pjesë e MSA-së, treshja Serbi-Shqipëri-Maqedoni e Veriut gëzojnë përfitimet dhe kanë detyrimet prej saj, që lidhen me tri lëvizje të lira: lëvizjen e mallrave, të shërbimeve dhe kapitaleve, pra integrimin e tregut me atë të BE-së. Ndërsa si pjesë e Marrëveshjes Shengen, treshja Serbi-Shqipëri-Maqedoni e Veriut përfitojnë dhe kanë detyrime që lidhen me lëvizjen e lirë të njerëzve në hapësirën e Shengenit, sipas rregullave që parasheh kjo marrëveshje për vendet candidate për në BE. Pra, me pak fjalë, duke qenë pjesë e MSA-së dhe e Shengenit, Shqipëria, Serbia

dhe Maqedonia e Veriut nuk kanë as çfarë shtojnë dhe as çfarë heqin mbi termat e tyre. Në kuadrin juridik e institucional të Bashkimit Evropian, MSA dhe Shengeni janë instrumente normative që, së bashku, rregullojnë katër lëvizjet e lira: të mallrave, shërbimeve, kapitaleve dhe njerëzve. Mirëpo, këto akte normative evropiane, sikundër parimet dhe vlerat evropiane përgjithësisht, nuk respektohen plotësisht në Ballkan.

Kjo frymë antinormative e Ballkanit ka të bëjë me kulturën antijuridike dhe filozofinë antieuropiane të liderëve dhe administratave ballkanike tash njëqind vjet. Liderë dhe administratë ballkanike historikisht kanë firmosur pa hezitim aktet juridike evropiane por, gjithashtu, po aq historikisht i kanë injoruar duke shkelur apo duke i gjymtuar ato, sidomos në aspektet e marrëdhënieve të fqinjësisë dhe të bashkëpunimit rajonal.

## 2. Shengeni serbo-centrist minon fqinjësinë e mirë dhe bashkëpunimin ballkanik

Synimi real i "Shengenit ballkanik serbo-centrist" është i dëmshëm dhe shumë i rrezikshëm për Kosovën, për Ballkanin dhe mbarë BE-në. Është i dëmshëm dhe i rrezikshëm për Kosovën sepse ka për qëllim izolimin e saj nga proceset ballkanike si shtet i pavarur dhe sovran, lënien e saj në kuadër të politikave të Serbisë, heqjen e pakushtëzuar të taksës së saj mbi importet serbe dhe krijimin e raporteve tërësisht të zbalancuara për Kosovën në kuadër të dialogut të prishur për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë.

"Shengeni ballkanik" është i dëmshëm dhe i rrezikshëm për Ballkanin sepse synimi dhe formati i tij do t'i ngjallë problemet e rivaliteteve fqinjësore në Ballkan dhe do ta dëmtojë frymën rajonale të bashkëpunimit. "Shengeni ballkanik serbo-centrist", duke rivënë Serbinë në qendër të Ballkanit Perëndimor, do t'i mbajë të ngrira problemet serioze me fqinjët e saj dhe do të krijojë premisa dominimi serb mbi pjesën e Ballkanit

Perëndimor. Këtë synim serb e kanë kuptuar mirë Mali i Zi, Bosnje Hercegovinë, Kroacia, të cilët kanë qëndruar mënjanë kësaj nisme.

Mbi të gjitha, "Shengeni ballkanik serbo-centrist" është i dëmshëm dhe i rrezikshëm edhe për mbarë Evropën dhe Euro-Atlantizmin. Në thelb, ky lloj Shengeni serbo-centrist tenton t'i hapë portat Rusisë. Sa kohë që politika dhe gjeostrategjia serbe është bivektorëse euro-ruse, duhet të kuptohet se çdo hap i Serbisë me fqinjët, Ballkanin dhe Evropën, i hap rrugën Rusisë për të depërtuar dhe për ta rritur praninë dhe ndikimin në fqinjët e Serbisë, në Ballkan dhe në mbarë Evropën.

Tanimë Serbia duket se po luan si "Kali i Trojës" i Rusisë në Ballkan dhe në Evropë. Shengeni serbo-centrist është një hap konkret i Serbisë për të krijuar një hapësirë gjeopolitike dhe gjeostrategjike të Rusisë në Ballkanin Perëndimor. Kjo po ndodh në një kohë kur NATO po rritë veprimet strategjike antiruse, ndërsa Bashkimi Evropian po ashpëson strategjinë kundër ofensivës ruse në Evropë.

## 3. Shengeni serbo-centrist, rrëshqitje drejt Unionit Ekonomik Euro-Aziatik

Më 20 gusht 2019 ambasadori rus në Serbi, Aleksander Botsan-Kharchenko, deklaroi se Serbia pritet që më 25 tetor të këtij ta firmosë viti paktin e tregtisë së lirë me Unionin Ekonomik Euro-Aziatik (EAEU) të udhëhequr nga Moska. Sipas ambasadorit Kharchenko, ky është një eveniment shumë sinjifikativ, prandaj edhe media po i kushton një rëndësi të madhe. Kharchenko thekson se hyrja e Serbisë në zonën e tregtisë së lirë do të shënojë një "faqe tërësisht të re të pranisë së Serbisë në Euro-Azi, duke hyrë në një treg me një kapacitet mbi 182 milionë konsumatorë dhe me një prodhim të brendshëm bruto me më shumë se 1.9 trilion dollarë". Unioni Ekonomik Euro-Aziatik është themeluar në vitin 2015 dhe përbëhet nga Rusia, Armenia, Kazakistani dhe Kirgistani. Serbia, si një aleate

jetësore e Rusisë, bazuar në lidhje fetare dhe kulturore prej shumë vitesh nuk heq dorë por, përkundrazi, po i ripërtërin dhe po i zgjeron marrëdhëniet me Moskën, në planin politik, diplomatik, ekonomik, tregtar dhe strategjik e ushtarak. Ndërkohë, Serbia vazhdon përpjekjet e saj, natyrisht jo fort të zellshme, për t'iu bashkuar anëtarësisht në Bashkimin Evropian si dhe për të ndërtuar marrëdhënie të mira me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Qartësisht, Serbia po ndjek një politikë bivektorëse: euro-perëndimore, njëkohësisht Euro-Aziatike, ose më saktësisht euro-ruse.

Rusia është tejet e interesuar që të ketë një aleat të vjetër dhe të qëndrueshëm brenda Bashkimit Evropian. Kjo i nevojitet Putinit për tri arsye kryesore: së pari, për imazh dhe propagandë të suksesit të penetrimit të Rusisë në Perëndim për konsum politik të brendshëm dhe rajonal; së dyti, për ta zgjeruar praninë dhe influencën në rritje në Ballkan dhe; së treti, gjithashtu për ta përdorur Serbinë, just in case, si instrument bllokues i vendimarrjeve politike të mbarë BE-së në qasjet ndaj Rusisë.

Bashkimi Evropian e ka parë me shqetësim këtë lojë dyfishtë të Serbisë, por ka qenë i pafuqishëm për ta parandaluar atë. Nga ana tjetër, sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, duke shprehur në mënyrën e tij shqetësimin e ShBA-së për politikën bivektorale të Serbisë, e inkurajoi presidentin serb, Vuçiq, në takimin e tij në Nju Jork më 20 gusht 2019, që "të fokusohet në qëllimin strategjik (të integrimin në Bashkimin Evropian) duke përsheptuar reformat e brendshme dhe përmbyllur negociatat me Kosovën, bazuar në njohjen reciproke (Morgan Ortagus, zëdhënës i Departamentit të Shtetit ShBA).

## 4. Ballkani, tri fazat drejt të shkuarës

Bashkimi Evropian dhe ShBA-ja vijojnë të tentojnë ta tërheqin, me rrugë e forma të ndryshme Serbinë drejt orientimit strategjik Evropian dhe Euro-Atlantik. Por, pavarësisht kësaj lojë diplomatike, Serbia vijon

me fanatizëm të dukshëm politikën e saj bivektorale euroatlantike dhe njëkohësisht Euro-Aziatike. Madje, kohën e fundit balanca e orientimit të Serbisë duket se po anon më shumë drejt Euro-Aziatizmit. Kjo duket në faktin se, pas firmosjes së marrëveshjes strategjike për programe të bashkëta ushtarake si dhe për blerje armatimesh nga Rusia, Serbia po shkon së shpejti për ta firmosur hyrjen në Unionin Ekonomik Euro-Aziatik me Moskën në krye. Pra, po institucionalizohet bashkëpunimi dypalësh serbo-rus dhe bashkëpunimi shumëpalësh serbo-euro-aziatik.

Vështruar në këtë kontekst, duhet parë dhe analizuar edhe Shengeni serbo-centrist ballkanik i Novi Sadit, përmes të cilit Serbia synon njëkohësisht që t'i hapë portat e pranisë dhe ndikimit rus në Ballkanin Perëndimor si dhe ta rrëshqasë gradualisht këtë pjesë të dobët, të pastabilizuar dhe të fragmentuar të Ballkanit drejt orientimit bivektorial Euro-Atlantik, njëherësh Euro-Aziatik. E pafuqishme për t'i shpëputur tërësisht vendet e Ballkanit Perëndimor nga aspiratat Euro-Atlantike, Rusia putiniste po synon që, së paku, të arrijë t'i diversifikojë orientimet strategjike të këtyre vendeve sa Euro-Atlantike, po aq edhe Euro-Aziatike. Ky diversifikim, ose kjo përçarje e kohezionit Euro-Atlantik e Ballkanit Perëndimor, pa dyshim se do të përdoret nga Rusia në momentet konjunkturalisht të përshtatshme për interesat e saj. Pra, strategjia ruse në Ballkanin Perëndimor synon të realizohet nëpërmjet tri fazave: në fazë afatshkurtër, në prishjen e kohezionit Euro-Atlantik; në fazë afatmesme, në diversifikimin midis Euro-Atlantizmit dhe Euro-Aziatizmit; dhe në fazë afatgjatë në rikthimin e dominimit rus në Ballkanin Perëndimor, ose kthimin në të shkuarën. Agresiviteti rus, dobësitë e BE-së, dilemat e ShBA-së dhe në mënyrë të veçantë shërbimi i devotshëm ruso-fil i Serbisë, e lehtësojnë realizimin e mundshëm të strategjisë ruse në Ballkanin Perëndimor. Shengeni serbo-centrist ballkanik është një investim serbo-rus drejt të shkuarës.



## Refuzohet kërkesa e kryeministrit britanik për votim të marrëveshjes për Brexit

LONDËR, 21 TETOR - Kryetari i Parlamentit britanik, John Bercow, ka refuzuar kërkesën e Qeverisë britanike për të votuar rreth marrëveshjes për largim të Britanisë nga Bashkimi Evropian.

Kryeministri britanik, Boris Johnson, ka arritur marrëveshje me BE-në për Brexitin javën e kaluar, mirëpo ajo duhet ta ketë edhe miratimin e Parlamentit të Britanisë.

Bercow ka thënë se kërkesa për votim të marrëveshjes është

sjellë përpara parlamentit edhe të shtunën, andaj një miratim i dyfishtë i thirrjes do të ishin "përsëritje" e debatit.

Në seancën e mbajtur të shtunën, ligjvënësit janë pajtuar që marrëveshja e Johnsonit nuk mund të zbatohet derisa të kthehet në ligj, me miratim të deputetëve.

Qeveria britanike, në anën tjetër, insiston që ky shtet duhet të largohet nga BE-ja më 31 tetor. Teksa kanë mbetur vetëm 10 ditë deri në datën kur

Mbretëria e Bashkuar është planifikuar të largohet nga blloku evropian, kushtet e divorcit janë sërish të paqarta, meqë disa politikanë britanikë kërkojnë marrëveshje, të tjerë largim pa pakt dhe ka zëra për referendum të dytë.

Vendimi për largim të Britanisë nga blloku evropian ka ardhur pasi 52 për qind e votuesve kanë votuar për dalje të Britanisë nga BE-ja kundruall 48 për qind që e kanë kundërshtuar atë, në referendumin e mbajtur më 2016.



## Trupat amerikane braktisin Sirinë, vendosen në Irak

Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Mark Esper, ka thënë se të gjitha trupat amerikane që tërhiqen nga pjesa veriore e Sirisë do të zhvendosen në pjesën perëndimore të Irakut dhe rreth 1 000 ushtarët amerikanë do të jenë në gjendje gatishmërie në rast se paraqitet kërcënim nga rigrupimi i militantëve të Shtetit Islamik

WASHINGTON, 21 TETOR - Të gjitha trupat amerikane që tërhiqen nga pjesa veriore e Sirisë do të zhvendosen në pjesën perëndimore të Irakut, tha sekretari amerikan i Mbrojtjes, Mark Esper. Sipas planeve të tanishme, Esper tha se rreth 1 000 ushtarët amerikanë do të jenë në gjendje gatishmërie në rast se paraqitet kërcënim nga rigrupimi i militantëve të Shtetit Islamik. Esper nuk e përjashtoi mundësinë që forcat amerikane të kryejnë misione kundër terrorizmit nga Iraku në Siri. Por, ai u tha gazetarëve se detajet do të përpunohen me kalimin e kohës.

Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka thënë më herët se këto trupa do të kthehen në shtëpi. Trump, megjithatë, shkroi në "Twitter" se "ushtarët amerikanë nuk janë në zona luftimesh apo armëpushimi". Njoftimi i tij, rreth dy javë më parë, për tërheqjen e trupave amerikane nga Siria, i ka hapur rrugë një ofensive të ushtrisë turke kundër milicive kurde në veri të Sirisë. Turqia i konsideron këto milici si terroriste dhe i do larg kufirit të saj, ndonëse ato kanë qenë aleate kyçe të ShBA-së në luftën

kundër Shtetit Islamik.

Ofensiva që ka zgjatur tetë ditë ka lënë qindra njerëz të vrarë dhe të plagosur dhe mijëra të tjerë të zhvendosur.

Një marrëveshje për armë-

pushim pesëditësh është arritur të enjten, për t'iu mundësuar milicive kurde të tërhiqen rreth 30 kilometra larg kufirit.

Të dyja palët e kanë akuzuar njëra-tjetrën për shkelje të armëpushimit.

Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, paralajmëroi se do ta rinisë ofensivën nëse milicitë kurde nuk tërhiqen plotësisht deri të martën mbrëma. "Nëse armëpushimi funksionon, funksionon. Nëse jo, sapo të kalojnë 120 orë nga armëpushimi, do të vazhdojmë aty ku e kemi lënë. Do të vazh-

dojmë t'i shtypim kokat e terroristëve", tha Erdogan.

Zyrtarë të lartë amerikanë e kanë kritikuar ashpër vendimin e presidentit Trump për tërheqjen e trupave nga veriu i Sirisë. Sipas disa kritikëve, vendimi i Trumpit ka qenë "tradhti" ndaj kurdëve, që kanë qenë aleatë kryesorë të ShBA-së në luftën kundër Shtetit Islamik dhe shumë prej tyre kanë shprehur shqetësimin se mijëra ekstremistë të këtij grupi, që aktualisht mbahen nga milicitë kurde, do të mund të ikin.

Sipas një zyrtari amerikan, i cili

ka folur në kushte anonimiteti, disa qindra ushtarë amerikanë tashmë janë larguar nga Siria.

Në një tjetër zhvillim, kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve të ShBA-së, Nancy Pelosi, dhe një grup i ligjvënësve amerikanë kanë arritur në Jordani për bisedime me Mbretin Abdullah. Agjencia shtetërore e lajmeve në Jordani, Petra, raportoi se Mbreti Abdullah, në takim me amerikanët, ka theksuar rëndësinë e ruajtjes së integritetit territorial të Sirisë dhe të kthimit "të sigurt dhe vullnetar" të refugjatëve.



## Berlini, i hapur për një shtyrje të shkurtër të Brexitit

BERLIN, 21 TETOR - Ministri gjerman i Punëve të Jashtme, Heiko Maas, nuk përjashtoi të hënën një shtyrje të shkurtër teknike për zbatimin e një Brexitit të detyruar. "Gjermania e kon-

sideron të mundshme një shtyrje të shkurtër teknike të datës së Brexitit nëse Parlamenti britanik përfundon duke miratuar marrëveshjen për daljen nga Bashkimi Evropian",

deklaroj të hënën ministri i Punëve të Jashtme Heiko Maas. "Nuk do ta përjashtoja faktin se mund të ketë një shtyrje të shkurtër teknike në rastin kur Britania e Madhe të hasë prob-

leme në procesin e ratifikimit të marrëveshjes së negociuar mes kryeministrit, Boris Johnson dhe Bashkimit Evropian", deklaroi ministri. "Në rast se Parlamenti britanik e hedh sër-

ish poshtë marrëveshjen, atëherë një vendim për një shtyrje të mundshme do të merret nga partnerët evropianë", tha ai në një konferencë me gazetarë në Berlin.





## AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla  
"RITMO - L"  
Prishtinë**

**Eksperiencia jonë  
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:  
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:**

**044 248 173**

**044 200 604**

**044 375 333**



E jashtëzakonshme

## Delet pushtojnë kryeqytetin e vendit evropian

Rrugët e Madridit u pushtuan nga një numër i stërmadh delesh për Festën e Trashumançias. Shoferët u detyruan ta lirojnë rrugën e të bëjnë vend për mbi 1 800 dele merinos dhe 100 dhi që kaluan në rrugët e qytetit. Kjo është një traditë bujqësore që vazhdon prej qindra vjetësh, kur barinjët i kthenin delet nga kullotat verore dhe i mbyllnin nëpër stalla para se të vinte dimri.



Festivalet e mëparshme kanë pasur me dhjetëra mijëra kokë dele, shumë më tepër se tani.

FOTO E DITES



Mbrojtësi francez i Rennes, Faitout Maouassa (L), feston duke e shikuar kamerën pasi shënoi një gol gjatë ndeshjes Monako - Rennes. /AP/

E rrallë

## Skulptori që kthen cungjet e pemëve në vepra arti

Një skulptor 22-vjeçar ka vendosur që të kthejë atë që mbetet nga pemët e rëna në qytetin e vet në vepra arti. Andrea Gandini, një 22-vjeçar nga Roma, ka nisur këtë punë që pesë vjet më parë dhe tani sapo ka përfunduar skulpturën e 66. Ai ka shumë materiale për të punuar, pasi Roma, një nga



qytetet më të gjelbra në Evropë, ka rreth 313 mijë pemë nëpër parqe dhe nëpër rrugët e qytetit.

## BARSOLETA E DITËS



Hyri një grua me dy fëmijë në një kafiteri, i afrova kamerierit dhe ai e pyeti:  
- Çfarë doni të pini?  
Gruaja:  
- Mbusheni këtë (ia jep cucllën)!



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora

14:00

## ABOMINABLE 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 32 min

Rolet: Chloe Bennet, Tenzing Norgay Trainor, Albert Tsai, Eddie Izzard, Sarah Paulson, Tsai Chin, Michelle Wong, etj.  
Regjia: Jill Culton



Çdo ditë në ora 16:00

## TOY STORY 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.  
Regjia: Josh Cooley



Çdo ditë në ora 18:00 dhe 20:00

## MALEFICENT MISTRESS OF EVIL 3D

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 orë 58 min

Rolet: Angelina Jolie, Elle Fanning, Chiwetel Ejiofor, Sam Riley, Ed Skrein, Imelda Staunton, Juno Temple, Michelle Pfeiffer, etj.  
Regjia: Joachim Ronning



Çdo ditë në ora 22:00

## ZOMBIELAND DOUBLE TAP

Aksion/Komedi/Horror; 1 orë 39 min

Rolet: Woody Harrelson, Jesse Eisenberg, Emma Stone, Abigail Breslin, Rosario Dawson, Zoey Deutch, Luke Wilson, etj.

Regjia: Ruben Fleischer



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), **fb: Kino ABC.**




**DASHI**

T'i bëni gjërat me forcë nuk do t'ju bëjë që t'i realizoni qëllimet tuaja. Ju nuk mund t'i shtyni njerëzit të jenë atje ku dëshironi që ata të jenë, sepse ata duhet të arrijnë vetë atje.



**DEMI**

Ju dhe një mik po afroheni më afër dhe duket se secili prej jush është tifozi më i madh i tjetrit. Por kjo shoqëri admirimi e ndërsjellë që ju filluat do të jetë e tepërt për disa të tjerë, prandaj kini kujdes që të dy mos dërgoni mesazhe të gabuara.



**BINJAKËT**

Sot duhet ta kuptoni ndryshimin midis një beteje nga e cila mund të fitoni, dhe një luftë nga e cila thjesht duhet të largoheni. Ju keni harxhuar shumë energji dhe durim në një seri pengesash që nuk do të largohen.



**GAFORRJA**

Ide të çuditshme do të vijnë sot në kokën tuaj majtas dhe djathtas dhe sa më të çmendura të jenë, aq më mirë! Nëse jeni duke punuar për të ndërtuar një romancë, mund ta arrini qëllimin tuaj shumë shpejt.



**LUANI**

Partneri juaj mendon se ai ose ajo di më së miri për një projekt të caktuar sot, por ju e dini më mirë ose të paktën ju mendoni se e dini.  
**VIRGJËRESHA**



Sot ndjenjat do t'ju pengojnë në rrugën tuaj duke ju larguar nga realizimi i asaj që duhet të bëni. Pra, nëse jeni duke punuar për të arritur afatet tani, ju duhet ta zhvendosni fokusin tuaj larg ideve emocionale dhe drejt të menduarit analitik.



**PESHORJA**

Jeta juaj ka qenë e qetë kohët e fundit, por rezultojnë se nuk është saktësisht ajo që keni dashur, në fund të fundit. Disa nga të lindurit në shenjën tuaj kërkojnë disa aventura, madje edhe dramë në të cilën mund të zhyten plotësisht.



**AKREPI**

Mos lejoni që arroganca e dikujt tjetër të futet nën lëkurën tuaj sot sepse nuk do t'ju ndihmojë për asgjë. Ju do të zhgënjeheni, por ata do të mbeten të lumtur, të paditur dhe bezdisës.



**SHIGJETARI**

Jeni një perfeksionist i pandreqshëm! Ju mund të identifikoheni duke qenë të pakënaqur në veten tuaj, por kjo nuk ju ndihmon ta kaloni ditën pa stres. Sot mund të jetë një ditë e mirë si në profesion ashtu edhe në dashuri.



**BRICJAPI**

A po ndiheni shumë i kufizuar nga një marrëdhënie? A mendoni se po mbyteni nga ky person? Para se ta ndiqni dëshirën e brendshme për të ikur prej tyre, ndaloni! Ju duhet të mendoni plotësisht për të gjitha opsionet përpara se të veproni sot.



**UJORI**

Si mund të largoheni nga gabimet e së kaluarës kur nuk doni që t'i harroni ato? Ju jeni një person i mrekullueshëm, por jo i përsosur, sepse askush nuk është i tillë. Kështu që jepini vetes një përqaftim emocional sot dhe shikoni përpara.



**PESHQIT**

Energjia juaj do të lulëzojë më së miri në një mjedis më të qetë, ku ju jeni vetëm ose shoqëroheni vetëm nga një ose dy persona të tjerë. Mundësia për të realizuar planet tuaja është më e madhe.



## Lady Gaga sërish beqare



**L**ady Gaga është sërish beqare. Këngëtarja 33-vjeçare këtë e ka konfirmuar në "Instagram". "Për një grua të martuar dhe si unë një grua beqare", ka shkruar ajo mbi një fotografi me shoqen e vet Sarah Nicole Tanno, në festën e saj të

beqarisë. Gaga u pa duke u puthur me Dan Horton gjatë muajit korrik, ndërsa ishte në një studio në Kaliforni. Ajo më së shumti i mbajti marrëdhëniet private, megjithëse u shfaq sërish në një darkë me Dan gjatë muajit shtator.

## Irina Shayk, provokuese me një fustan të kuq në Nju Jork



**A**jo është një nga femrat dhe modelet më të bukura në botë, që mahnit dhe befason sa herë që shfaqet në publik. Irina Shayk është fotografuar në Nju Jork, duke dalë nga një restorant, veshur me një fustan të

kuq, të çarë deri lart në kofshë, duke treguar format e përkryera dhe të tonifikuara. Pavarësisht prej divorcit nga partneri i saj Bradley Cooper, me të cilin ka dhe një vajzë, modeluesja ruse duket e mrekullueshme.



## Rita Ora rrëmben çmimin 'Latin American Music Awards 2019'

**K**ëngëtarja shqiptare Rita Ora vazhdon të korrë sukses në arenën ndërkombëtare. Ajo ka rrëmbyer çmimin për videon më të mirë në "Latin American Music Awards 2019" me këngën "R.I.P" në bashkëpunim me Sofia Reyes dhe

Anit. Vajzat e publikuan në mars të këtij viti këngën "R.I.P", që numëron 134 milionë klikime në "Instagram". Në këtë kategori, Rita mposhti emra të njohur siç janë Maluma, Daddy Yankee, Camila e të tjerë.

## Jennifer Lawrence martohet pak muaj pas fejesës



**J**ennifer Lawrence dhe Cooke Maroney janë zyrtarisht të martuar. Aktorja, fituese e çmimit Oscar, u martua me 34-vjeçarin të shtunën në mbrëmje, në një ceremoni në Newport, Rhode Island, konfirmon "People".

Jennifer dhe Coke u fejuan në muajin shkurt pasi filluan lidhjen në pranverën e vitit 2018. Ata u prezantuan nga shoqja e tyre e ndërsjellë Laura Simpson, e cila shoqëroi në mënyrë të famshme aktoren në Oscar në vitin 2014.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

# Rijad Bytyqi, e ardhmja e portës së Kosovës

16-vjeçari Rijad Bytyqi është një garanci për portën e U17-shave të Kosovës, kurse në të ardhmen edhe e Përfaqësueses A. Karriera e tij mori një hovë të jashtëzakonshëm që prej ndeshjeve kualifikuese për Evropianin "Estonia 2020", ku së bashku me shokët e përfaqësueses dhe trajnerin Besnik Kollari e ndalën kampionen e Evropës, Holandën. Trajneri i "tulipanëve", Mischa Visser, pas ndeshjes ka thënë: "Atij do t'i ndërtohet një statujë në Kosovë". Kjo deklaratë e ka motivuar edhe me shumë Bytyqin që ta vazhdojë rrugëtimin drejt Përfaqësueses A dhe transferimin në një klub evropian

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 21 TETOR - Samir Ujkani, Arjanet Muriq dhe Visar Bekaj aktualisht janë tre portierët e parë në Përfaqësuesen A të Kosovës në futboll, por "Dardanët" duket se do ta kenë të sigurt portën edhe për shumë e shumë vjet të tjera. Në ardhje është një yll që ka filluar të lëshojë shkëndijat e para të cilat tregojnë se e ardhmja e tij është e sigurt në një klub të madh evropian. Fjala është për Rijad Bytyqin, që është pjesë e shkollës së futbollit "Roni 19" në kategorinë e juniorëve dhe e Përfaqësueses së Kosovës U17. Bytyqi karrierën e ka nisur në ShF "Minatori" me trajner Gazmend Osmanin, ku edhe është zbuluar talenti i madh që ka për lojën e futbollit, konkretisht për pozitën e portierit.

Portieri i ri më pas kaloi në shkollën e futbollit "Roni 19", me trajner ish-futbollistin e dëshmuar në futbollin e Kosovës dhe më gjerë, Faruk Statovcin. Rijadi për "Epokën e re" ka treguar se kushtet në klubin e tij janë shumë të mira për t'u zhvilluar si futbollist. "Që katër-pesë vjet jam pjesë e shkollës së futbollit 'Roni 19' dhe gjithçka është duke shkuar shumë mirë. Kushtet janë shumë të mira, pasi kemi edhe fitnessin dhe transportin. Mendoj se ka hapësirë për t'u zhvilluar si futbollist", ka thënë Bytyqi, i cili tashmë është 16-vjeçar.

Rrugëtimi i këtij djaloshi nuk ishte aspak i lehtë, por shumë i suksesshëm. Ai tregoi edhe për arritjen deri në Përfaqësuesen U17. "Më 5 tetor 2017 është mbajtur kampi nacional për lojtarët e Përfaqësueses U15. Atëkohë kam qenë 14-vjeçar dhe janë testuar qindra lojtarë dhe dhjetëra portierë, përfshirë edhe mua. Pjesë e kampit ishin të gjitha regjionet e Kosovës. Unë isha pjesë e regjionit të Prishtinës që kishte dy ekipe. Trajneri im ishte Artan Bytyqi. Në këtë kamp kam rënë në sytë



e dy trajnerëve të Përfaqësueses U15, Gazmend Halitit dhe Isa Sadriut. Ata më kanë ftuar edhe në kampet e tjera dhe loja e parë e imja për Kosovën U15 ishte ndaj Shqipërisë më 3 maj. Kështu kemi vazhduar edhe në U16 e më pas në U17 me trajnerin Besnik Kollari", ka thënë Rijadi.

Kulmi i deritashëm i suksesit për portierin Bytyqi ishte ndeshja e zhvilluar ditë më parë ndaj kampionëve aktualë të Evropës për grupmoshën U17 të Holandës. Kjo ishte ndeshja e parë në kualifikimet për Evropianin "Estonia 2020", në kuadër të Grupit të 12-të, derisa përfundoi 1-1. Rijad Bytyqi në këtë 90 minutësh shkëlqeu ani pse pësoi një gol, Holandës ia mohoi edhe shumë të tjerë. Trajneri i "tulipanëve", Mischa Visser, pas ndeshjes, ka thënë se: "Atij do t'i ndërtohet një statujë në Kosovë". Bytyqi ka thënë për gazetë se kjo deklaratë e trajnerit do të jetë një motiv më i madh që ta vazhdojë punën për ta arritur majën në futbollin botëror. "Loja me

Holandën ka qenë shumë e vështirë, sepse kishim përballë një kombëtare që është vatër e talenteve të futbollit, me një akademi të jashtëzakonshme, ku luajnë lojtarë të Manchester Unitedit, PSV-së dhe të Ajaxit. Ne kemi menduar të zhvillojmë një lojë defensive për shkak se ta sulmosh një kombëtare të tillë mund të pranosh shumë gola. Jemi përgatitur me trajnerët për një lojë defensive dhe është dashur që në atë ndeshje të jemi të fokusuar për shkak se secili rast ka qenë më i rrezikshëm se tjetri. Faza defensive, por edhe unë është dashur të jemi shumë të koncentruar dhe në fund së bashku ia kemi arritur qëllimit. Deklaratat e trajnerit të tyre nuk i kam pritur, por performanca e mirë që kam pasur gjatë lojës më ka ndihmuar t'i marr ato dhe shumë lëvdata të tjera. Normalisht se ajo deklaratë me motivon të vazhdoj të punoj edhe më shumë për t'i arritur majat e futbollit dhe të tregoj se Kosova është vend i talenteve", ka thënë Bytyqi.

## Ofertat nga Superliga dhe ëndrra e madhe

Talenti i madh që ka portieri i ri, Rijad Bytyqi, ka rënë në sytë e shumë skuadrave në Kosovë. Ai ka treguar se ka pasur mjaft oferta, përfshirë edhe dy nga skuadrat e Superligës, por synimi i tij është Evropa. "Kam pasur oferta prej klubeve në Kosovë, nga Superliga dhe Liga e Parë. Kam pasur ofertë prej Llapit për kontratë profesionale, derisa më ka kërkuar edhe Ballkani për të luajtur si juniorë, por për të qenë edhe portier i tretë në ekipin e parë. Qëllimi im është të arrij në Përfaqësuesen A dhe të transferohem në Evropë", ka thënë Bytyqi. Skuadra e Barcelonës është ëndrra e madhe e 16-vjeçarit që beson se me punë të madhe mund t'ia arrijë realizimit të kësaj ëndrrë.



## SHKURT

### 'Dardanët' fillojnë përgatitjet për rrethin e dytë kualifikues

Përfaqësuesja e Kosovës në futsall e ka zhvilluar stërvitjen e parë në kuadër të përgatitjeve për rrethin e dytë kualifikues të Botërorit 2020, që do të mbahet prej 23 deri më 28 tetor në Shkup. "Dardanët" e futsallit janë grumbulluar në hotel "Venus", derisa stërvitjet po i zhvillojnë në palestrën "Diloni Benz". Kosova do të udhëtojë në Shkup të mërkurën, kurse ndeshjen e parë do ta zhvillojë të enjten në orën 17:30 kundër Ukrainës. Në orë të njëjtë, më 25 tetor, Kosova përballlet me Maqedoninë e Veriut, kurse më 27 tetor nga ora 20:00 takohet me Slloveninë.

### Çekiçi: Kam oferta nga Spanja dhe Polonia

Endri Çekiç po kalon një çast mjaft të mirë me skuadrën e Olimpias së Ljubljanës në kampionatin slloven. Shqiptari është shndërruar në një protagonist absolut të skuadra e tij, teksa oferta për të nuk kanë munguar. Në një prononcim për "Zona Gol", Çekiçi ka zbuluar se ka oferta nga klube spanjolle dhe polake, teksa në merkaton e janarit mund të vijë transferimi i shumëpritur. "Kam oferta nga klube spanjolle dhe polake. Në merkaton e janarit mund ta bëj transferimin. Për sa i përket kombëtares, nuk kam biseduar me Rejën, por lumturohem që isha në listën e pritjes", ka thënë Çekiçi.

### Ronaldo: Dua tituj kolektivë, jo individual

Ylli i Juventusit dhe Portugalisë, Cristiano Ronaldo, ka thënë se dëshiron të fitojë trofe me "Zonjën e Vjetër", pastaj vijnë çmimet individuale. "Çdo vit ka një sfidë të re. Gjëja më e rëndësishme është të fitojmë tituj si skuadër. Ne duhet të zhvillohemi edhe më shumë si skuadër. Tani aspekti individual nuk ka rëndësi. Është ndeshja e radhës që duhet ta fitojmë. Nëse fitojmë 50 për qind jemi të kualifikuar", ka thënë Ronaldo. "Ne duam t'i fitojmë të gjithë titujt. Ne duhet të mendojmë të fitojmë së bashku dhe jo individualisht. Nuk mendoj se 'Topi i Artë' do të ishte gëzim i madh për mua se sa të fitonim tituj kolektivisht, andaj unë them se ne duam të fitojmë tituj së bashku dhe jo individualisht", ka shtuar Ronaldo.



## Mosmarrëveshje në mes të Hamiltonit dhe drejtuesve të Mercedesit

LONDËR, 21 TETOR - Lewis Hamiltoni e mbylli në vendin e tretë garën e fundit në Suzuka, pas shokut të vet të skuadrës të Mercedesit, Valtteri Bottas dhe Sebastian Vettel me Ferrari. Një rezultat që ende nuk e lë të qetë pilotin britanik edhe pse ka

kaluar një javë nga ajo garë. Ndërkohë, këtë fundjavë botërori i Formulës 1 do të s'potohet në Meksikë. Në prag të garës së radhës, Hamiltoni lëshon një sinjal të qartë: "Nuk e kuptova atë strategji në Japoni, që më kushtoi me vendin e dytë,

madje me fitore. Gjithsesi, kjo është një çështje e skuadrës dhe ata morën një vendim. Shpresoj se këto gabime të mos përsëriten më", ka thënë Hamiltoni. Nga ana tjetër, Toto Wolff nuk është aspak i shqetësuar nga

këto fjalë të kampionit të botës. "Është e qartë që pilotët duan të fitojnë gjithnjë dhe nëse dështon ata mërzhiten. Ndonjëherë është e vështirë t'i marrësh vendimet e duhura, por ky debat me Lewisin nuk na shqetëson, përkundrazi", ka deklaruar Wolffin.



## Reali kërkon fitoren e parë, Tottenhami këndelljen



ISTANBUL, 21 TETOR - Skuadra më e trofeshme në botë, Real Madridi, kërkon fitoren e parë në këtë edicion të Ligës së Kampionëve. Skuadra spanjolle zhvilloi dy ndeshje në grupin A, njëren e humbi 3-0 nga Paris Saint-Germain, kurse në ndeshjen tjetër luajti baras 2-2 ndaj Club Brugge. Sonte (e martë), Reali, i drejtuar nga Zinedine Zidane, kërkon fitoren ndaj skuadrës turke, Galatasarayt. Në këtë ndeshje "Mbretërit" vijnë pas humbjes që e regjistruan të shtunën në La Liga kundër Mallorcës (1-0) dhe kjo humbje i kushtoi edhe me humbjen e vendit të parë që tash është në pronësi të Barcelonës.

Në anën tjetër skuadra turke, Galatasaray, të premtën e mposhti Sivassporin (3-2) dhe aktualisht zë pozitën e pestë në kampionatin elitare të Turqisë me 13 pikë. Radamel Falcao ka humbur katër ndeshjet e fundit për shkak të lëndimit, por mund të jetë i përfshirë në ndeshjen ndaj Realit. Mungesë do të jetë mes-

fushori i huazuar nga Southamptoni, Mario Lemina, derisa Emre Akbaba nuk do të rikthehet deri në vitin 2020. Christian Luyindama do të jetë i gatshëm pasi luajti pjesën më të madhe ndaj lojës kundër Sivassporit. Në anën tjetër, Reali do të jetë pa Nachon, Luka Modriqin, Gareth Balen dhe Marco Asension, por rikthehet Toni Kroos që do të luajë në mes-fushë bashkë me Casemiro dhe Federico Valverde. Edhe Dani Carvajal dhe Eden Hazard do të rikthehen në skuadër, pasi pushuan në ndeshjen e fundjavës. Në ndeshjen tjetër të këtij grupi, PSG-ja kërkon fitoren e tretë në këtë edicion të garës me të fortë në futboll ndaj Club Brugges në mënyrë që ta forcojë pozitën e parë në tabelë. Këndellje pas humbjes së thellë nga Bayern Muncheni pret edhe skuadra e Tottenham Hotspurit, e cila e pret skuadrën e Crvena Zvezdas. Tri pikë të reja janë synim edhe i Bayernit në ndeshjen ndaj grekëve të Olympiacosit.

GRUPI A		
21:00 Club Brugge - Paris Saint-Germain		
21:00 Galatasaray - Real Madrid		
Tabela		PIKË
1. Paris Saint-Germain	2	6
2. Club Brugge	2	2
3. Galatasaray	2	1
4. Real Madrid	2	1
GRUPI B		
21:00 Olympiacos - Bayern M.		
21:00 Tottenham H. - Crvena Zvezda		
Tabela		PIKË
1. Bayern	2	6
2. Crvena Zvezda	2	3
3. Olympiacos	2	1
4. Tottenham	2	1
GRUPI C		
18:55 Shakhtar Donetsk - Dinamo Zagreb		
21:00 Manchester City - Atalanta		
Tabela		PIKË
1. Manchester City	2	6
2. Shakhtar	2	3
3. Dinamo	2	3
4. Atalanta	2	0
GRUPI D		
18:55 Atletico Madrid - B.Leverkusen		
21:00 Juventus - Lokomotiv M.		
Tabela		PIKË
1. Atletico M.	2	4
2. Juventus	2	4
3. Lokomotiva M.	2	3
4. b.Leverkusen	2	0

## Milwaukee e papërmbyajtshme në miqësore, Antetokounmpo paralajmëron rivalet

MILWAUKEE, 21 TETOR - Pesë ndeshje miqësore të luajtura, pesë fitore për skuadrën e Milwaukee Bucksit, që paraqitet në këtë sezon të ri të NBA-së në formë të jashtëzakonshme. Ashtu sikurse edhe ylli i këtij ekipi, greku Giannis Antetokounmpo, ishte MVP i sezonit të rregullt vitin e kaluar. Kjo gjë nuk ndodhte që nga viti 1997, çka e bën ekipin e Bucksit një pretendent serioz për titull. "Është diçka pozitive kur e nis sezonin e ri me të gjitha ndesh-



jet miqësore të fituara. Gjithsesi, e dimë që tani e tutje do të bëhet gjithnjë e më e vështirë. Dimë se kemi ndërtuar një ekip të fortë, që do të shkojë përpara këtë sezon. Jemi një ekip i frikshëm

dhe këtë gjë do ta tregojmë në fushë në çdo ndeshje", ka thënë Antetokounmpo. Edhe vjet skuadra e Milwaukeees ishte pretendente për titull, madje pati rezultatin më të mirë në sezonin e rregullt, por zhgënjëu në finalët e Konferencës së Lindjes. "Ndoshta nuk isha gati për ato ndeshje, edhe pse ajo fazë është ndryshe nga kjo e sezonit të rregullt. Kemi një vit me shumë përvojë, ndaj do të jetë ndryshe për ne", ka shtuar MVP-ja.

### SHKURT

#### Reali kontakton Mourinhon

Real Madridi, pas rezultateve të dobëta, po mendon ta rikthejë në klub trajnerin Jose Mourinho. Sipas programit televiziv spanjoll "El Chiringuito", Reali i ka nisur kontaktet me Jose Mourinhon, i cili është i papunë momentalisht. Skuadra e Zinedine Zidanes humbi 1-0 kundër Real Mallorcës të dielën, një rezultat ky që veçse e rriti presionin edhe më shumë ndaj trajnerit francez. Si pasojë e humbjes së Realit, rivalja e përbetuar, Barcelona, e mori kreun e La Ligës të dielën. Reali s'i ka punët aspak mirë as në Ligën e Kampionëve, prandaj presidenti i klubit Florentino Perez e ka kontaktuar Mourinhon, me shpresë që ta kthejë në stolin e Madridit. Trajneri portugez e udhëhoqi "Los Blancos" për tri vjet, nga viti 2010 deri më 2013.

#### Rashford: Meritum tri pikë ndaj Liverpoolit

Sulmuesi i Manchester Unitedit, Marcos Rashford, nuk është kënaqur me barazimin 1-1 ndaj Liverpoolit. Rashford shënoi golin e parë në ndeshje, por në minutën e 85-të Lallana barazoi shifrat, duke bërë që kampioni i Evropës të arrijë të fitojë një pikë. "Mendoj se i meritum tri pikë dhe mund të them se luajtëm mirë. Liverpooli nuk e meritoi barazimin e aq më pak fitoren. E shoh ndeshjen si dy pikë të humbura për ne, por duhet të vazhdojmë të përmirësohemi", ka thënë Rashford.

#### Rodriguezi humb vendin e titullarit në Milan, e ardhmja në Gjermani

Prej kohësh i kritikuar dhe tashmë jo më titullar te Milani, Ricardo Rodriguez pritet të rikthehet në Gjermani. Për mbrojtësin zviceran drejtuesit kuqezinj nuk do të refuzonin oferta të rëndësishme dhe një të tillë pritet ta bëjë Borussia Dortmundi që po kërkon përforcime për krahët e mbrojtjes. Rodriguezi ka kontratë deri në vitin 2021 me Milanin dhe me një ofertë prej 15 deri në 17 milionë euro palët do ta arrinin marrëveshjen që do t'i kënaqte të dyja klubet. Për mbrojtësin 27-vjeçar do të ishte një rikthim në Bundesliga aty ku ka shkëlqyer më parë me Wolfsburgun, ndërsa te Milani nuk arriti asnjëherë të shfaqej deçiziv në këta tre sezone.

#### Van der Vaart: I gjej tre lojtarë si Maguire në futbollin amator

Mbrojtësi anglez Harry Maguire u transferua me shumë bujë në merkaton e verës nga skuadra e Leicester Cityt drejt Manchester Unitedit për shifrën rekord 92 milionë euro. Ky transferim shkaktoi shumë polemika, teksa të shumtë ishin njerëzit e botës së futbollit të cilët e cilësuan shumë si të ekzagjeruar. Një prej tyre është edhe ish-mesfushori holandez Rafael Van der Vaart.

Ish-futbollisti i Realit të Madridit nuk i ka kursyer komentet thumbuese për 26-vjeçarin e Unitedit pas barazimit ndaj Liverpoolit, teksa u shpreh: "Kur shikoj futboll amator të dielave, i gjej tre lojtarë të cilët luajnë si Maguire. E kam seriozisht. Mund të tingëllojë budallallëk, ama nuk na dëgjon ai, gjithsesi. Në fund të fundit, po flasim për një lojtar që ka kushtuar 90 milionë euro. Atëherë Van Dijk vlen 300 milionë euro. Gjatë Ligës së Kombeve unë punoja për televizionin holandez. Më kujtohet kur thoshim: Harry Maguire ishte lojtari më i dobët në fushë. Dy muaj më vonë, ai kushtoi 92 milionë euro".





Sot me datë 22 tetor bëhen dhjetë vjet pa ty

## **Naile Shpati**

Të jetosh në zemrat e gjithkujt do të thotë të mos vdesësh kurrë.

*Të përkujton: Bashkëshorti Dini e fëmijët; Shendriti, Anita, Eronita e Arbenita..*



Sot me datë 22 tetor bëhen dhjetë vjet pa ty

## **Naile Shpati**

Kur ta hedhësh dheun mbi trupin e më të dashurve tuaj, atëherë e kupton se sa e pavlerë është kjo botë. Po na mungon shumë.

*Të kujton: Halla Shehrije me fëmijë.*





Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Korporata Energjetike e Kosovës" sh.a Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për përgatitjen e planit të detajuar të prodhimit dhe investimeve për minierën e re në Sibovc komuna e Obiliqit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 20.11.2019 në ora 11:00 në adresën KEK Sh.a, DPQ – miniera e "Mirashit" në sallën e takimeve Obiliq do të organizohet debat publik nga kompania "Korporata Energjetike e Kosovës" sh.a Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për përgatitjen e planit të detajuar të prodhimit dhe investimeve për minierën e re në Sibovc komuna e Obiliqit.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

**KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS**

[www.kek-energy.com](http://www.kek-energy.com)

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Gurishta-Zh" Sh.p.k Zhur, Prizren, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për gurthyesin me seperacion në Zhur komuna e Prizrenit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 18.11.2019 në ora 11:00 në hapësirat e objektit të kompanisë "Gurishta-Zh" Sh.p.k në Brija Zhur komuna e Prizrenit do të organizohet debat publik nga kompania "Gurishta-Zh" Sh.p.k Zhur, Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për gurthyesin me seperacion në Zhur komuna e Prizrenit.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

C.nr. 2361/12

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Ylber Shurdhiqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Ilir Dugolli, nga Prishtina, të cilin e përfaqëson Naser Peci, avokat në Prishtinë, kundër të paditurit Senad Namgalija, nga Prishtina, Bregu i Diellit, Zona Lindje, Lamela 4, kati 3 banesa nr.4, tani në adresë të panjohur, për vërtetim të pronësisë, jashtë seance me datën 15.10.2019, merr këtë:

#### AKTVENDIM

Të paditurit Senad Namgalija, nga Prishtina, Bregu i Diellit, Zona Lindje, Lamela 4, kati 3 banesa nr.4, tani në adresë të panjohur, i CAKTOHET përfaqësuesi i përkohshëm, Veton Robaj, avokat nga Prishtina.

Përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha autorizimet në këtë çështje, për të ndërmarrë të gjitha veprimet juridike për mbrojtjen e interesave të të paditurit, deri në momentin kur i padituri të paraqitet personalisht në gjykatë, të caktojë të autorizuarin e tij, apo deri në momentin kur organi i kujdestarisë - Qendra për Punë Sociale në Prishtinë, ti caktoj kujdestarin.

Shpenzimet për përfaqësuesin e përkohshëm i bartë pala paditëse.

Ky aktvendim do të publikohet në mjetet e informimit publik, tabelën e shpalljeve të kësaj Gjykate, Gazetën Zyrtare, po ashtu i dorëzohet përfaqësuesit të përkohshëm të paditurit, të autorizuarit të paditësit dhe Organit të Kujdestarisë.

Revokohet Aktvendimi C.nr.2361/12, i datës 07.02.2014.

#### Arsyetim

Pran kësaj gjykate është iniciuar kontesti për vërtetim të pronësisë, sipas shenjës C.nr.2361/12, me palë paditësit Ilir Dugolli, nga Prishtina kundër të paditurit Senad Namgalija, nga Prishtina, Bregu i Diellit, Zona Lindje, Lamela 4, kati 3 banesa nr.4, tani në adresë të panjohur, për vërtetim të pronësisë.

Gjykata ka provuar të paditurit Senad Namgalija, nga Prishtina, Bregu i Diellit, Zona Lindje, Lamela 4, kati 3 banesa nr. 4, ti dorëzoj aktvendimin për përgjigje në padi dhe padinë së bashku me provat e bashkangjitura në padi, mirëpo nga fletë kthesa është konstatuar se i padituri është i panjohur në këtë adresë dhe në hyrje të kësaj adrese nuk e njeh askush dhe se adresa nuk është e plotë.

Mbi këto arsye dhe sipas propozimit të palës paditëse gjykata ka vendosur që të paditurit me aktvendimin C.nr.3261/12, të datës 07.02.2014, ti ka caktuar përfaqësues të përkohshëm Selim Nikçi, avokat nga Prishtina, pasi që adresa e të paditurit ka qenë e pa njohur.

Gjykata aktvendimin C.nr.2361/12, të datës 07.02.2014, i ka dorëzuar të autorizuarit të paditësit, përfaqësuesit të përkohshëm dhe Qendrës për Punë Sociale në Prishtinë, por nuk e ka dorëzuar edhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Gjykata ka caktuar seancën gjyqësore për datë 02.07.2019, në të cilën seancë i autorizuarit i paditësit ka propozuar gjykatës që të revokohet aktvendimi i mëhershëm për përfaqësues të përkohshëm sepse aktvendimi në fjalë nuk i është dorëzuar Gazetës Zyrtare të Kosovës për publikim dhe të paditurit ti caktoj përfaqësuesin e përkohshëm në kuptim të dispozitave të LPK-së, pasi që adresa e të paditurit është e pa njohur.

Gjykata me datë 16.10.2019, ka kërkuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës që lidhur me këtë çështje civilo-juridike të caktoj një avokat nga radha e avokatëve të regjistruar pranë kësaj ode.

Me parashtrësën e datës 16.10.2019, Oda e Avokatëve të Kosovës i është përgjigjur gjykatës në kërkesën për përfaqësues të përkohshëm dhe ka caktuar Veton Robaj, avokat nga Prishtina.


Mbi këto arsye dhe sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse gjykata ka vendosur që të paditurit Senad Namgalija, tani në adresë të panjohur, t'i caktoj përfaqësuesin e përkohshëm Veton Robaj, avokat nga Prishtina, pasi që në rastin konkret nuk dihet adresa e të paditurit.

Revokimi i vendimit C.nr.2361/12, i datës 07.02.2014, është bërë pasi që ky aktvendim në kohën kur është nxjerr nuk i është dorëzuar Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës për publikim dhe në ndërkohë gjyqtari i cili ka qenë i ngarkuar me këtë lëndë ka kaluar në gjykatën e Apelit të Kosovës, ndërsa i njëjti aktvendim tani në kohën kur është caktuar seanca nuk ka mundur të dorëzohet në Gazetën Zyrtare të Kosovës për publikim sepse tani këtë lëndë e ka në trajtim gjyqtari tjetër.

Nga sa u tha më lartë, u vendos në kuptim të nenit 79,3 germa (a), nenit 81.82 dhe 83 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.2361/12, dt. 15.10.2019

KËSHILLË JURIDIKE:  
kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.







Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Mbrojtjes  
Ministarstvo Odbrane / Ministry of Defense  
Drejtoria e Burimeve Njerëzore/Direktorat Ljudskih Resurs/Human Resources  
Directorate

Duke bazuar në nenin 5 të Ligjit Nr. 06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, nenin 6 të Ligjit Nr.06/L-124 për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës, si dhe nenin 12 të Rregullores Nr.02/2013 për Rekrutimin në FSK, Ministria e Mbrojtjes shpall:

### KONKURS

Për rekrutimin e kadetëve për shkollim në Akademinë e Forcave Ajrore dhe Akademinë Ushtarake –West Point të Shteteve të Bashkuara të Amerikës

#### A. Kandidati që aplikon për kadet duhet;

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- Të ketë kryer shkollën e mesme, përfshirë edhe testin kombëtar të maturës,
- Të mos jetë nën hetime, i/dënuar apo i/e ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë,
- Të jetë jo më pak se 18 vjeç dhe nuk duhet të kalojë ditëlindjen 23-të deri më 1 korrik (2020) të vitit në të cilin kandidatët hyjnë në Akademinë e Forcave Ajrore dhe Akademinë Ushtarake West Point,
- Të jetë me status të ligjshëm të shtetit dhe të ketë karakter të mirë moral,
- Kandidatët nuk duhet të jenë të martuar, ose të kenë ndonjë detyrim tjetër ligjor për të mbajtur një apo më shumë fëmijë, si dhe femrat të mos jenë në periudhën e shtatëzënisë,
- Të plotësoj standardet e larta për udhëheqje, akademike, fizike dhe mjekësore.
- Kandidatët duhet të kenë njohuri të mira me rrjedhshmëri të mjaftueshme të gjuhës angleze në të folur, shkruar dhe në të kuptuar.
- Të ketë njohuri të larta në lexim, të shkruar dhe folur të anglishtes bashkëkohore.
- Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme) të tjera; të mos ketë kaluar apo të vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepaticke, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe lëvizjes) apo të ketë qenë ose jetë përdorues i lëndëve narkotike. Secili i emëruar duhet të ketë shikim të mirë dhe pa ndonjë problem dental të theksuar.
- Të ketë notën jo më pak se katër (4) gjatë shkollimit të mesëm.
- Të arrijë pikët në testin SAT matematikë jo më pak se 580 pikë dhe testi në shkrim dhe lexim të bazuar në prova (EBRW) jo më pak se 480 pikë.
- Të kalojë me sukses Vlerësimin të Kandidatit përgatitje fizike, i cili përbëhet nga ngritje, pompa, muskuj të barkut, kërcim nga një anë në tjetrën, gjuajtje në basketboll dhe vrapim një mile.

#### B. Procedurat e testimit;

- Testi Fizik
- Testi i Ineligjencies
- Testi ECL
- Testi TOEFL
- Testi SAT (Provues)
- Testi SAT
- Intervista,
- Kontrollimi Mjekësor.

#### C. Dokumente për aplikim;

- Diploma origjinale e shkollës së mesme (përveç origjinalit duhet të ofrohet edhe versioni zyrtar i diplomës së shkollës së mesme i përkthyer në gjuhën angleze),
- Tri vlerësime shkollare zyrtare (letra rekomandimi),
- Dëshmi, certifikata, mirënjohje (nëse posedon),
- Ekstrakti i lindjes,
- Vërtetimin nga gjykata që nuk është nën hetime apo i ndjekur penalisht (origjinal),
- Kopje të letërnjoftimit apo pasaportës,
- Dy fotografi të formatit (5 cm x 5 cm).

#### D. Shënim;

- Pas përfundimit të procedurës së testimit, kandidatët do të nominohen nga Ministria e Mbrojtjes si kandidatë konkurrent për studim në Akademinë e Forcave Ajrore dhe Akademinë Ushtarake WEST POINT në SHBA.
- Procesi i përzgjedhjes/nominimit të kandidatëve do të përfundojë deri më 01.12.2019,
- Konfirmimi i përzgjedhjes për shkollim në Prill 2020,
- **Fillimi i shkollimit-Korrik 2020.**
- **Kandidatët të cilët janë në fazën e përfundimit të shkollës së mesme gjatë vitit shkollor 2020, do të mund t'ju nënshtrohen procedurave të testimit me kusht që në rast të përzgjedhjes, diplomat e shkollës së mesme ti sjellin jo më larg 15 qershor 2020.**

#### F. Si të aplikoni;

Formularët për aplikim janë në dispozicion në ueb-faqen e Ministrisë së Mbrojtjes, [mod.rks-gov.net](http://mod.rks-gov.net) ku gjendet konkursi i shpallur. Formularët duhet të dorëzohen personalisht, në Zyrën e Rekrutimit, Shtabi i Përgjithshëm i FSK-së, në çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00 deri në afatin e fundit për konkurrim. Kandidatët duhet t'ia bashkëngjisin aplikacionit kopjet e dokumenteve që dëshmojnë përmbushjen e kushteve të nevojshme. Dokumentet e pranuar nuk kthehen. Për informata plotësuese, mund të kontaktoni në nr.tel. 038-603-199, 038-603-355.

#### Afati i konkurimit:

Konkursi është i hapur prej 22.10.2019 deri më 04.11.2019.

Ministria e Mbrojtjes iu shërben të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet e femrave dhe meshkujve, pa dallim nga përkatësia e tyre etnike.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Mbrojtjes  
Ministarstvo Odbrane / Ministry of Defense  
Drejtoria e Burimeve Njerëzore/Direktorat Ljudskih Resurs/Human Resources  
Directorate

Na osnovu člana 5 Zakona br. 06/L-122 o Ministarstvu Odbrane Republike Kosovo, član 6 Zakona br. 06/L-124 o službi u Kosovskim Bezbednosnim Snagama i član 12 Pravilnika br. 02/2013 o Regrutovanju u KBS-u, Ministarstvo Odbrane najavljuje:

### KONKURS

Za regrutovanju kadeta za školovanje na Akademiji Vazduhoplovstva i Vojnu Akademiji - West Point Sjedinjenih Američkih Država

#### A. Kandidat koji se prijavljuje za kadeta mora;

- Biti državljanin Republike Kosovo,
- Imati završenu srednju školu, uključujući i nacionalni test mature,
- Da nisu kažnjeni/e ili krivično gonjeni/e od strane pravosudnih organa,
- Mora biti mlade od 18 godina i ne sme pređi 23. rođendan do 1. jula 2020. godine, u kojem kandidati upisuju vazduhoplovnu akademiju i vojnu akademiju West Point,
- Biti pravnog državnog statusa i imati dobar moralni karakter,
- Kandidat ne bi trebali biti u braku ili imati bilo kakvu drugu zakonsku obavezu da drže jedno ili više dece, a žene ne bi trebale biti u trudnoći,
- Da ispuni visoke standarde za akademsku, fizičku i medicinsku liderstvo.
- Kandidat moraju imati dobro znanje sa dovoljnim engleskog jezika govorni, pisanja i razumevanja.
- Dobro poznavati čitanje, pisanje i govorenje savremeno engleskog jezika.
- Da nije prenosilac HIV-a, hepatitisa B i drugih SPB-a (seksualno prenosive bolesti); nisu patili ili su već patili od drugih bolesti srca, bubrega, jetre, pluća, neuropsihijatrijskog, lokomotornog sistema (koštani i pokretni sistem) ili su bili ili su uživaoci narkotika. Svaki imenovani treba da ima dobar vid i nema značajnih stomatoloških problema.
- Imati ocenu najmanje četiri (4) tokom srednje škole.
- Postići SAT matematički rezultat ne manje od 580 bodova, a test pisanja i čitanja na osnovu dokaza (EBRW) ne manji od 480 bodova.
- Da uspešno prode procenu kandidata za fizičke pripreme, koji se sastoji od podizanja, sklekovi, stomačnih mišica (trbušnjaci), skičanje sa jedne na drugu stranu, šutiranje u košarci i trčanje jednu milju.

#### B. Procedure testiranja;

- Fizički Test
- Test Inteligencije
- ECL Test
- TEFL Test
- SAT Test (Probni)
- SAT Test
- Intervju,
- Medicinski pregled.

#### C. Dokumentacija za prijavljivanje;

- Diploma srednje škole u originalu (osim originala treba se dostaviti i službena verzija diplome prevedena na engleskom jeziku),
- Tri službena školska ocenjivanja (preporučeni papir),
- Potvrde, sertifikati, zahvalnice (ako poseduje),
- Ekstrakt rođenih,
- Potvrda suda da se protiv lica ne vodi istraga ili da nije krivično gonjen (original),
- Kopija lične karte ili pasoša,
- Dve slike formata 5 cm x 5 cm.

#### D. Napomena;

- Nakon završetka postupka testiranja, kandidati će biti nominirani od strane Ministarstva Odbrane kao kandidati konkurentni za studije na Vazduhoplovstvom Akademiji i Vojnoj Akademiji WEST POINT SAD.
- Procesi izbora/nominacije kandidata će završiti do 01.12.2019,
- Potvrda o izboru za školovanje u Aprilu 2020,
- **Početak školovanja –Juli 2020.**
- **Kandidati koji su u fazi završetka u srednjoj školi tokom školske godine 2020. mogu biti podvrgnuti procedurama testiranja pod uslovom da se u slučaju izbora diplome srednje škole donesu najkasnije do 15. juna 2020. godine.**

#### F. Kako se prijaviti;

Obrasci prijave su na raspolaganju na veb stranici Ministarstva Odbrane, [mod.rks-gov.net](http://mod.rks-gov.net) gde je objavljen konkurs. Obrasci se trebaju lično dostaviti na kancelariju za regrutovanju, Generalni Štab KBS-a, n svakog radnog dana od 09:00-15:00 do zadnjeg dana roka za konkurisanje. Kandidat treba da prilože obrascu kopije dokumenata koje potvrđuju da su potrebni uslovi ispunjeni. Priljeni dokumenti se ne vraćaju. Za dodatne informacije, možete kontaktirati na br.tel. 038-603-199, 038-603-355.

#### Rok konkurisanja:

Konkurs je otvoren od 22.10.2019 do 04.11.2019.

Ministarstvo Odbrane služi svim građanima Kosova i pozdravlja prijavljivanje žena i muškaraca, bez obzira na njihovu etničku pripadnost.



**Njoftimi për shprehje të interesit**Emri i shkollës: **“Planjane”**Komuna: **Prizren**Data: **22.10.2019**

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/089-G/1.1	Furnizimi me aparate teknologjike

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles SHFMU “Planjane” Planjane, Prizren. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

**Furnizimi me aparate teknologjike (Furnizimi me tablet kompjutera – 20 kom)**

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
  - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
  - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën e SHFMU “Planjane” Planjane, Prizren, më së largu deri më **30.10.2019**.
4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur **Ftesë për ofertë-Mallra**, do t’ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t’i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Alen Azari

Telefoni: 044/356-448

E-maili: o.s.planjane@hotmail.com

**Poziv za izražavanje interesa**Škola: **„25. maj”, Donje Ljubinje**Opština: **Prizren**Datum: **22.10. 2019.**Naziv ugovora: **Obuka nastavnika (upotreba informatičke opreme)**Broj ugovora: **ESIP/C1.4/081 - ESIP/SDG/081-CS/1.4**

Vlada Kosova je dobila kredit od grupe Svetske banke za Projekat poboljšanja obrazovnog sistema (PPOS), i namerava da deo sredstava iz ovog kredita izdvoji za podršku Ministarstvu obrazovanja, nauke i tehnologije i OI NSŠ, **„25. maj”, Donje Ljubinje, Prizren**. Kao deo ove podrške sledeća nabavka potrebne opreme će se odvijati:

1. Opis potrebne robe: **Obuka nastavnika (upotreba informatičke opreme) u Prizrenu.**
2. Minimalni kriterijumi za kvalifikovanje izvođača radova da imaju pravo da se prijave su:
  - Uspešno iskustvo u izvršenju najmanje 2 ugovora o robi slične prirode tokom poslednje dve godine;
  - Pravna registracija firme od strane lokalnih vlasti.
3. Zainteresovani izvođači koji ispunjavaju navedene minimalne kvalifikacione uslove sudobro došli da se prijave svojim izražavanjem interesa detaljne tehničke specifikacije na adresi OI NSŠ **„25. maj”, Donje Ljubinje, Prizren** najkasnije **30.10. 2019.**
4. Detaljna tehnička specifikacija, zajedno sa drugim uslovima, sve pripremljeno u jednom dokumentu pod nazivom Poziv za dostavu ponude za robu će biti dostavljeni od strane škole samo za one izvođače koji ispunjavaju kriterijume. Kompanije se mole da dostave svoje kontakt podatke prilikom podnošenja svog interesovanja.

Kontakt detalji škole:

Kontakt osoba: **Asim Karadolami**Broj telefona: **049 340 495**e-majl: **asim-76@hotmail.com****Kërkesa për shprehje të interesit**Emri i shkollës: **“Restelica”**Komuna: **Dragaš**Data: **22.10.2019**

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/006-CS/1.1/ESIP/C1.3/006	Trajnim: <b>Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie</b>

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles **“Restelica” Restelica, Dragaš**.

Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZhSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t’i planifikojnë dhe t’i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulentëve të nevojshme:

Trajnim: **Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie****Kualifikimet e firmës konsulente:**

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulentëve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhitën në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;

**Kriteret e vlerësimit:**

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulentëve nga fusha e teknologjisë informativë (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme apo IT (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

**Procesi i seleksionimit:**

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore” të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: **“Restelica” Restelica, Dragaš**, më së largu deri më **30.10. 2019**.

Firmat e interesuara të konsulentëve mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: **Jusuf Hodža**Telefoni: **044/532 505**E-maili: **onss-restelica@hotmail.com****Njoftimi për shprehje të interesit**Emri i shkollës: **“Zenuni”**Komuna: **Dragash**Data: **22.10.2019**

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/007-G/1.1	Furnizimi me aparate teknologjike

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles SHFMU **“Zenuni” Brod, Dragash**. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

**Furnizimi me aparate teknologjike**

- **Lap topa 6 copa**

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën e SHFMU **“Zenuni” Brod, Dragash**, më së largu deri më **30.10.2019**.

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur **Ftesë për ofertë-Mallra**, do t’ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t’i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: **Cenan Skenderoski**Telefoni: **044/494 155**E-maili: **cenanbrod@hotmail.com**





Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A  
Kosova Landfill Management Company J.S.C  
Rr.Bekim Fehmiu 137,Lakrishtë,10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 (0) 38 600 551; 600 552  
www.kmdk-ks.org

### Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A

Komisioni i Auditimit të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Republikën e Kosovës (KMDK SH.A), në mbledhjen e mbajtur me datë 18/09/2019, duke u bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në bazë të nenit 21 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në bazë të nenit 26.6 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, si dhe në bazë Rregullores Nr. 01/2017 për Procedurat e Punësimit, Strukturën Organizative, Kategorizimin dhe Përshkrimin e Vendeve të Punës në KMDK SH.A ka vendosur të rishpallë:

#### Rishpallje e Konkursit Publik për pozitën:

##### 1. Pozita: Zyrтари i Auditimit të Brendshëm të KMDK SH.A (1 pozitë)

Vendi i punës: KMDK SH.A, Zyrat Qendrore Prishtinë

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përveç detyrave të parapara me Ligj, Statut dhe Kodin e Etikës.
- Përpilimi i procedurave të auditimit, gjegjësisht planit të brendshëm për të gjitha transaksionet e kompanisë konform objektivave të kontrollit të brendshëm, politikave dhe procedurave të kompanisë të bazuara në legjislacionin të aplikueshëm.
- Auditimi i planeve të investimeve dhe financave të kompanisë, planit vjetor të biznesit dhe buxhetin vjetor.
- Auditimi i pasqyrës vjetore të bilancit dhe deklaratat e fitimeve dhe humbjeve si dhe deklaratat financiare që kërkohen me ligj.
- Vlerësimi objektiv dhe shfrytëzimi efektiv i burimeve të Kompanisë dhënia e rekomandimeve adekuate për Komisionin e Auditimit dhe Menaxhmentin e Kompanisë.
- Verifikimi i përshtatshmërisë dhe funksionimi i rregullt i sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të garantojnë zbatimin e të gjitha ligjeve të aplikueshme në Kosovë nga Kompania gjatë veprimtarisë, dhe ti sigurojë Komisionit të Auditimit çfarëdo vërejtje ose sugjerime të cilat konsiderohen të nevojshme.
- Verifikimi i rregullt i përshtatshmërisë dhe funksionimit të rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë qëllim që të sigurojnë se librat dhe dokumentacioni i kompanisë duke përfshirë dokumentacionin financiar, mbahen në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe me ligjin, si dhe përgatitja e rregullt e deklaratave vjetore financiare.
- Analiza sistematike e proceseve të biznesit dhe kontrolleve të ndërlidhura me to.
- Raportimi i rregullt para Komisionit të Auditimit dhe përmbushja e çfarëdo detyre tjetër të përcaktuar nga Komisioni i Auditimit.
- Udhëheqë dhe menaxhon organizimin e brendshëm të zyrës së auditimit.
- Udhëheqë dhe drejton të gjitha aktivitetet e auditimit të brendshëm.
- Për punën e tij i përgjigjet Komisionit të Auditimit.

#### Kualifikimi:

- Të parapara me Ligj, Statut dhe Kontratë të Punës.
- Diplomë Universitare në fushën financiare, duke u ndërlidhur me trajnim dhe eksperiencë.
- Përvojë pune së paku 3 vjeçare e dëshmuar në menaxhim financiar dhe në përpilimin e raporteve financiare **të jetë Auditor i Qertifikuar**.
- Demonstrimi i aftësive të shkëlqyeshme të komunikimit dhe të bashkëpunimit me menaxhmentin dhe stafin e kompanisë.
- Demonstron pëlqimin me kërkesat nga Kodi i Etikës dhe praktikat e auditimit intern.
- Preferohet njohje e mirë e gjuhës angleze.

#### Informata të përgjithshme për kandidatë:

Përcaktimi i pagës për pozitën e shpallur bëhet në përputhje me aktet e brendshme të Kompanisë.

#### Procedura e konkurimit:

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin aplikacionin përkatës, të shoqëruar me nga një biografi personale (CV), nga një letër motivuese, si dhe dokumentacionin përkatës për përgatitjet shkollore dhe për përvojën e kërkuar të punës.

Forma e aplikacionit mund gjendet në Web-faqe ([www.kmdk-ks.org](http://www.kmdk-ks.org)) të KMDK-së.

Aplikacioni, me të gjitha dokumentet, mund të dorëzohet në kopje fizike në pliko të mbyllur në zyrën e Administratës së KMDK-së, në adresën: Rr.Bekim Fehmiu 137 Lakrishtë, afër shkollës Shtjefën Gjeçovi.

Afati për aplikim është 15 ditë nga dita e publikimit të Konkursit Publik duke filluar nga data: 22.10.2019 deri me datën 05.11.2019 ora 16:00.

Email: [info@kmdk-ks.org](mailto:info@kmdk-ks.org)



Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A  
Kosova Landfill Management Company J.S.C  
Rr.Bekim Fehmiu 137,Lakrishtë,10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 (0) 38 600 551; 600 552  
www.kmdk-ks.org

### Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A

Bordi i Drejtorëve të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Republikën e Kosovës (KMDK SH.A), në mbledhjen e mbajtur me datë 28/06/2019, duke u bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në bazë të nenit 21 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në bazë të nenit 26.6 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, si dhe në bazë Rregullores Nr. 01/2017 për Procedurat e Punësimit, Strukturën Organizative, Kategorizimin dhe Përshkrimin e Vendeve të Punës në KMDK SH.A ka vendosur të rishpallë:

#### Rishpallje e Konkursit Publik për pozitën:

##### 1. Pozita: Sekretar/e i/e Ndërmarrjes Publike KMDK SH.A (1 pozitë)

Vendi i punës: KMDK SH.A, zyrat qendrore Prishtinë

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të parapara me Ligjin për NP-të dhe Ligjin për Shoqërite Tregtare, si dhe Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.
- Mirëmban regjistrin e aksionarëve.
- Vepron si agjent i Kompanisë për pranimin e njoftimeve.
- Kryen të gjitha arkivimet, publikimet dhe/ose zbulimet për autoritetin përkatës siç mund të kërkohet me ligj ose me statut.
- Koordinon me Bordin e Drejtorëve, përgatitjen e letrave (dokumente) për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve.
- Mban procesverbalet e secilës mbledhje dhe mbledhjes së Përgjithshme të Bordit të Drejtorëve dhe Komiteteve të Bordit dhe kujdeset që ato të jenë protokoluara.
- Kryen dhe detyra të tjera me kërkesë të Bordit dhe Kryeshefit Ekzekutiv, në përputhje me rregulloret e brendshme të kompanisë.
- Për punën e vet i përgjigjet BD, ndërsa për punën e përditshme i përgjigjet KE-së.

#### Kualifikimi:

- Diplomë të Fakultetit Juridik.
- Përvojë pune 3 vjeçare.
- Dëshmi e përvojës së punës, Kontrata e punës ose Vërtetim i marrëdhënies së punës.
- Të ketë aftësi të komunikimit dhe të bashkëpunimit me menaxhmentin dhe stafin e Kompanisë.
- Të përmbushë kërkesat e parapara me Kodin e Etikës dhe praktikat e mira.
- Preferohet njohje e mirë e Gjuhës Angleze.
- Të mos jetë nën hetime për vepra penale.

#### Informata të përgjithshme për kandidatë:

Përcaktimi i pagës për pozitën e shpallur bëhet në përputhje me aktet e brendshme të Kompanisë.

#### Procedura e konkurimit:

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin aplikacionin përkatës, të shoqëruar me nga një biografi personale (CV), nga një letër motivuese si dhe dokumentacionin përkatës për përgatitjet shkollore dhe për përvojën e kërkuar të punës.

Forma e aplikacionit mund të gjendet në Web-faqe ([www.kmdk-ks.org](http://www.kmdk-ks.org)) të KMDK-së. Aplikacioni, me të gjitha dokumentet, duhet të dorëzohet në kopje fizike në pliko të mbyllur në zyrën e Administratës së KMDK-së, në adresën: Rr.Bekim Fehmiu 137 Lakrishtë, afër shkollës Shtjefën Gjeçovi.

Afati për aplikim është 15 ditë nga dita e publikimit të Konkursit Publik duke filluar nga data: 22.10.2019 deri me datën 05.11.2019 ora 16:00.

Email: [info@kmdk-ks.org](mailto:info@kmdk-ks.org)





Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A  
Kosova Landfill Management Company J.S.C  
Rr. Bekim Fehmiu 137, Lakshtë, 10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 (0) 38 600 551; 600 552  
www.kmdk-ks.org

## Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A

### Njoftim për Anulim të Konkursit Publik të dt.23.09.2019 për pozitën Zyrtar i Auditimit të brendshëm

E informojmë opinionin publik si dhe të gjithë aplikuesit për pozitën Zyrtar i Auditimit të Brendshëm në Kompaninë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A se Konkursi i Shpallur me dt.23.09.2019 është anuluar në bazë të Vendimit të Komitetit të Auditimit në mbledhjen e mbajtur me datë: 16.10.2019. Informimi i opinionit publik mbi mundësinë e Rishpalljes së Konkursit do të bëhet paraprakisht nëpërmjet mjeteve të Informimit publik.

Faleminderit për mirëkuptim!

#### Njoftim shprehje interesi

Emri i shkollës: "Migjeni"

Komuna: Malishevë

Data: 22.10.2019

Emri i kontratës: Paisja e klasës me PC dhe kamera të sigurisë dhe paisje përcjellëse.

Numri i kontratës: ESIP/SDG/054-G/1.1

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles "Migjeni", Lubizhde-Malishevë. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

**Laptop**

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën e shkolles "Migjeni"-Lubizhde-Malisheve, më së largu deri më 30.10.2019

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Sokol Paçarizi, Bajram Bytyçi

Telefoni: 044581906, 045 355392.

E-maili: shfmu-migjeni@hotmail.com

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Zejdije Preni shpall te pavlefshme dëftesën e Kl 1-5 , Shkolla Fillore "Ilaz Thaqi" Hani Elezit.

► Gyltene Ejup Mustafa nga Ferizaj shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit të Psikologjisë të lëshuar nga Kolegjit AAB-Prishtinë.

► Liridon Beqiri shpall të pavlefshme dëftesat e vitit të -I-, -II-, -III-, -IV- dhe diplomën e SHM të Mjekësisë "Xheladin Deda" në Mitrovicë.

► Zenel Tanushi shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf "Shtjefen Gjeqovi" Zym.

► Elmira Zinkovskaja shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf "Emin Duraku" Prizren

► Muhamet Bajrami shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

► Blerim Saramati shpall te pavlefshme dëftesat shmlt "11 Marsi" Prizren

► Gurr Gjonbalaj shpall te pavlefshme diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren

► Kërkoj shporet për nxehe qendrore me dru të përdorur, që mundet të ngrohe deri 1000 m2, numri kontaktues 044-608-626.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtime i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studenta, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/giejpuneshpeite





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

**RC COLA**  
Columbus, Georgia, USA  
Since 1909